



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SPORTIT

KORNIZA KURRIKULARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
(E PËRDITËSUAR)

Tiranë, 2024





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 8006 prot.

Tiranë, më 20.12 2024

URDHËR

Nr. 610 datë 20.12 2024

PËR

MIRATIMIN E KORNIZËS KURRIKULARE DHE PLANIN E VEPRIMTARIVE
PËR RISHIKIMIN DHE PËRDITËSIMIN E PAKETËS KURRIKULARE TË
ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të shkronjës “a” të pikës 2, të nenit 45 të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Kornizës Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar të Republikës së Shqipërisë dhe planin e veprimtarive për rishikimin dhe përditësimin e paketës kurrikulare, sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij Urdhri.
2. Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar ekzistuese, dokumentet e kurrikulave bërthamë dhe planet mësimore dhe programet lëndore qëndrojnë në fuqi deri në miratimin e kurrikulave sipas planit të veprimtarive për rishikimin dhe përditësimin e paketës kurrikulare që rrjedh nga ky dokument dhe afateve të zbatimit të tij.
3. Kurrikulat bërthamë, planet mësimore dhe programet lëndore miratohen sipas afateve me urdhër të Ministrit.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit parauniversitar.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

OGERTA MANASTIRLIU



TABELA E PËRMBAJTJES

I. HYRJE.....	4
II. NEVOJAT PËR PËRMIRËSIMET NË KURRIKUL.....	5
2.3. Koncepti i ri për të nxënit.....	6
2.4. Forcimi i identitetit kombëtar.....	6
2.5. Ndërvarësia dhe lëvizja në kontekstin evropian e më gjerë.....	7
2.6. Tranzicioni i gjelbër dhe zhvillimi i qëndrueshëm.....	7
2.7. Aftësimi profesional dhe aftësitë sipërmarrëse.....	8
III. QËLLIMET E SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR.....	10
IV. PARIMET E PËRGJITHSHME PËR ZHVILLIMIN E KURRIKULËS.....	10
4.1. Konceptimi holistik i kurrikulës që bazohet në kompetenca.....	10
4.2. Gjithëpërfshirja.....	11
4.3. Nxënie ndërdisiplinore dhe koherente.....	11
4.4. Aftësimi për jetën dhe botën e punës.....	12
4.5. Integrimi i teknologjisë në arsim.....	12
4.6. Bashkëpunimi dhe partneriteti.....	12
4.7. Autonomia dhe përgjegjshmëria.....	12
4.8. Ndërgjegjësimi global dhe kulturor:.....	13
4.9. Përmirësimi i vazhdueshëm i kurrikulës.....	13
V. KOMPETENCAT KYÇE EUROPIANE DHE REZULTATET E TË NXËNIT QË I DËSHMOJNË ATO NË PËRFUNDIM TË APU-SË ⁰	14
5.1. Kuptimi për kompetencat kyçe.....	14
5.2. Kompetenca e komunikimit në gjuhën amtare.....	15
5.3. Kompetenca e komunikimit në gjuhë të huaja.....	16
5.4. Kompetencat në matematikë, shkencë, teknologji dhe inxhinieri.....	16
5.5. Kompetenca digjitale.....	17
5.6. Kompetenca personale, shoqërore dhe e të nxënit.....	18
5.7. Kompetenca qytetare.....	19
5.8. Kompetenca e sipërmarrjes.....	20



5.9. Kompetenca për vetëdijen dhe shprehjen kulturore.....	20
VI. STRUKTURA, NIVELET E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DHE VEÇORITË	22
6.1. Struktura e arsimit parauniversitar	22
6.2. Nivelet arsimore	23
VII. FUSHAT KURRIKULARE DHE LËNDËT QË PËRFSHIJNË ⁰	28
7.1. Fusha “Gjuhët dhe komunikimi”	29
7.2. Fusha “Matematikë”	30
7.3. Fusha “Shkencat e natyrës”	30
7.4. Fusha “Shkencat shoqërore”	31
7.5. Fusha “Teknologji dhe TIK”	32
7.6. Fusha “Artet”	32
7.7. Fusha “Edukim fizik, sporte dhe shëndeti”	33
VIII. SHPËRNDARJA E KOHËS MËSIMORE PËR FUSHAT E TË NXËNIT.....	34
8.1 Shpërndarja e kohës sipas fushave të të nxënimit në arsimin bazë	35
8.2 Shpërndarja e kohës sipas fushave të të nxënimit në arsimin e mesëm të lartë	35
IX. TEMA NDËRKURRIKULARE.....	36
X. KURRIKULA ME ZGJEDHJE.....	37
10.1 Kurrikula me zgjedhje.....	37
10.2 Kurrikula në bazë shkolle.....	38
XI. METODOLOGJITË E TË NXËNIT EFEKTIV	39
XII. VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE	43
12.1 Kuptimi për vlerësimin, qëllimi dhe parimet themelore	43
12.2 Llojet e vlerësimit.....	44
12.2.1 Vlerësimi i brendshëm ⁰	44
12.2.2 Vlerësimi i jashtëm	45
XIII. DOKUMENTET KURRIKUARE QË BUROJNË NGA KORNIZA KURRIKULARE.....	47
XIV. KUSHTET PËR ZBATIMIN E KURRIKULËS	47
XV. FJALORI TERMINOLOGJIK.....	56



I. HYRJE

Përvojat e fituara nga zbatimi i kurrikulës së arsimit parauniversitar në dekadën e fundit mundësuan një vlerësim kritik të arritjeve dhe të kufizimeve, njëherazi edhe thellimin e kërkimit për ta përditësuar më tej. Ky vlerësim konsideroi edhe ndryshimet, nevojat dhe marrëdhëniet e reja që janë shfaqur në shoqërinë shqiptare dhe në tregun e punës, risitë teknologjike, aftësitë e reja etj. Këtyre nevojave dhe marrëdhënieve, kurríkula e arsimit parauniversitar duhet t'u përgjigjet me zhvillime të brendshme sasiore e cilësore, për të krijuar kushte dhe mundësi që nxënësit të ndërtojnë dhe të demonstrojnë njohuri, aftësi dhe vlera të përshtatshme për një shoqëri demokratike të dijes. Në këtë kontekst, përditësimi i kurrikulës është thelbësor për të garantuar që sistemi arsimor që përputhet me nevojat e shoqërisë dhe të sigurojë që nxënësit të kenë aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për të përballuar sfidat e sotme dhe të ardhshme.

Kurríkula e përditësuar ndërlidh proceset arsimore dhe administrative që mundësojnë orientimin dhe funksionimin e sistemit arsimor parauniversitar. Ajo bazohet në realitete historike, shoqërore, gjuhësore, politike, fetare, gjeografike dhe kulturore të vendit tonë. Me anë të saj mundësohet arsimimi cilësor dhe i barabartë për çdo pjesëtar të shoqërisë, pavarësisht përkatësisë etnike, pozitës shoqërore apo dallimeve të tjera.

Kurríkula jetësohet në një mori dokumentesh, materialesh mësimore, përvojash dhe procesesh. Ndër ta, Korniza Kurrikulare është dokumenti kryesor që synon të ofrojë një rrugë të qartë dhe të strukturuar për zhvillimin e këtyre dokumenteve kurrikulare dhe materialeve ndihmëse. Ky dokument përcakton qëllimet e përgjithshme të arsimit parauniversitar, duke u siguruar që të gjithë nxënësit të kenë qasje në një arsim cilësor që mbulon fushat kyçe të dijes dhe zhvillimin e kompetencave. Përmes një qasjeje të balancuar dhe gjithëpërfshirëse, korniza kurrikulare synon të mbështesë rritjen intelektuale, sociale, emocionale dhe fizike të çdo nxënësi, duke i përgatitur ata për të qenë qytetarë aktivë dhe të përgjegjshëm në një shoqëri që ndryshon vazhdimisht. Ajo është standardi kombëtar arsimor mbi bazën e të cilit institucionet arsimore zhvillojnë kurrikulat e tyre dhe u përgjigjen sfidave të arsimit në shekullin XXI.

Korniza Kurrikulare reflekton qasjen bashkëkohore kurrikulare që bazohet në kompetenca, e cila përqendrohet në zhvillimin e aftësive dhe të vlerave thelbësore të nxënësve, duke përfshirë aftësitë kritike, analitike, komunikuese, digjitale dhe bashkëpunuese. Kjo qasje synon të përgatisë nxënësit për të zbatuar dijen në situata reale dhe për të zhvilluar aftësitë që u nevojiten për të jetuar dhe



punuar në një shoqëri gjithnjë e më komplekse.

II. NEVOJAT PËR PËRMIRËSIMET NË KURRIKUL

Periodha e zbatimit të reformës kurrikulare së ndërmarrë në vitin 2014 është shoqëruar me ngjarje e ndryshime që kanë prekur në masë të madhe mundësinë e funksionimit normal të mekanizmave të zbatimit të reformës kurrikulare, ndërkohë që dukuri, të tilla si pandemia dhe nevoja e të mësuarit në distancë i vunë sistemet arsimore kudo në botë përballë të papriturave, por edhe përballë sfidës së përshpejtimit e “të djegies” së etapave normale të zbatimit të një reforme arsimore. Nga ana tjetër, kjo periudhë ofroi edhe shumë ide për zgjidhje të cilat duhet të mbahen parasysh në kushtet e një ndërmarrjeje të re, e cila shpalos dy objektiva madhorë:

- Përditësimi i kurrikulës, i motivuar nga ligjësitë e brendshme të zhvillimit e përmirësimit të saj dhe në përgjigje të kërkesave të reja të kohës ndaj shkollës dhe arsimit në përgjithësi.
- Rritja e efektivitetit të mekanizmave të realizimit të politikave arsimore dhe ngritjes së mekanizmave të rinj, nëse zbatimi cilësor i politikës arsimore e kërkon një gjë të tillë.

Në mënyrë më të detajuar, faktorët kryesorë që diktojnë përditësimin e kurrikulës, janë:

2.1. Ndryshimet shoqërore dhe politike

Prej shumë vitesh Evropa po përballlet me rreziqe që minojnë kulturën e demokracisë të vlerave dhe parimeve të saj. Kthimi tek luftërat, tek ideologjia radikaliste dhe ekstremizmi i dhunshëm, praktikat e diskriminimit, e gjuhës së urrejtjes, ndryshimet mjedisore e klimatike, rritja e intolerancës ndaj asaj që perceptohet si e ndryshme, ulja e interesat, deri në indiferentizëm të plotë ndaj integritetit të pakicave etj., kanë rritur pasigurinë për të sotmen dhe të ardhmen.

Ky realitet ka rritur sfidat ndaj sistemit arsimor i cili **duhet rishikojë misionin e tij qytetar dhe demokratik**, në të cilin nxënësit mund të kenë shansin të zhvillohen dhe të fitojnë aftësitë e nevojshme për të ruajtur demokracinë dhe bashkekzistencën paqësore demokratike.

Përpara arsimit shqiptar shtrohet nevoja e **rishikimit të kurrikulës së lëndës së Qytetarisë**, e lëndëve shoqërore dhe e gjithë politikës së shkollës, në funksion të krijimit të mjedisit të sigurt për të mësuar dhe luftarak ndaj çdo ideologjie e praktike që mbështet ose nxit dhunën dhe ekstremizmin në zgjidhjen e problemeve e konflikteve.

Edukimi i të drejtave të njeriut, edukimi ligjor, edukimi për paqe, edukimi për integritet dhe kundër korrupsionit duhet të jenë disa nga **përparësitë pikënisëse** të reformës së lëndës së Qytetarisë.

2.2. Rritja e vazhdueshme e informacionit dhe edukimi për median dhe informimin



Shoqëritë në të cilën jetojmë sot drejtohen nga informacioni dhe dijet. Ne nuk mund t'i shpëtojmë pranisë së kudondodhur të medias dhe të gjitha formave të teknologjive të informimit dhe komunikimit si dhe rolit që ato luajnë në jetët tona personale, ekonomike, politike dhe shoqërore. Vendimet që marrin njerëzit dhe në veçanti të rinjtë kushtëzohen nga algoritmet që ofrohen nga fusha e medias. Por, për këtë arsye, janë shtuar edhe rreziqet e mundshme për individin dhe shoqërinë nëse sistemet e IA nuk përdoren si duhet në shërbim të njeriut.

Kjo kërkon që edukimi për median dhe informimin të jetë jetësor për fuqizimin e gjithanshëm të njerëzve dhe përparësi e politikës arsimore.


Arsimi shqiptar, duke konsideruar si parësor krijimin e kushteve dhe të mundësive që nxënësit të zhvillojnë **kompetencën digjitale**, të menduarit kompjuterik dhe aftësitë e kodimit nëpërmjet platformave për përvoja të personalizuara të nxënies, laboratorëve virtualë, softuerëve arsimorë, simulimeve ndërvepruese dhe burimeve të tjera digjitale, të cilat lehtësojnë mësimin praktik në formatin digjital, duhet edhe të përcaktojë me kujdes se mbi ç'bazë do të zgjidhet përmbajtja e asaj që duhet të mësohet, si do të përcaktohet ajo që është e rëndësishme për nxënësin nga sasia aktuale e informacionit, si do të ndërtohen dhe do të strukturohen njohuritë e marra dhe për ç'qëllim.

2.3. Koncepti i ri për të nxënësit

Koncepti bashkëkohor për të nxënësit thekson rëndësinë e një qasjeje holistike në arsim, e cila synon përvetësimin e njohurive të reja dhe të kompetencave. Të nxënësit, tashmë, përfshin ndërtimin dhe gjenerimin e dijeve, jo thjesht depozitimin e tyre në kujtesën e nxënësve; shndërrimin e dijeve të reja disiplinore dhe shkencore në njohuri të reja personale nëpërmjet nxënies, përdorimit dhe kërkimit real; zhvillimin e mënyrave të larmishme me të cilat krijohet dhe komunikohen konceptet dhe idetë në botën e sotme; ndërveprimet, marrëdhëniet mes sistemeve të ndryshme të dijes dhe mënyrave të ndryshme të paraqitjes së tyre. Kështu, njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet vetjake do të organizohen në struktura fleksibël që mundësojnë përdorimin e tyre. Kjo kërkon ndryshimin e roleve të mësuesve të cilët duhet të jenë, gjithnjë e më shumë, organizatorë të procesit mësimor, ndihmës të nxënësve dhe vlerësues të arritjeve të tyre.

2.4. Forcimi i identitetit kombëtar

Lëvizjet e mëdha të popullsisë tonë kërkojnë një qasje e angazhim më kompleks e më komplementar për ruajtjen dhe forcimin e identitetit kombëtar përmes arsimit. Këtë synim kurrikula e arsimit parauniversitar e promovon nëpërmjet krijimit të kushteve dhe të mundësive



për studimin e historisë dhe kulturës tonë kombëtare, përmirësimin të nxënies së gjuhës dhe të letërsisë shqipe, studimit të traditave dhe vlerave kombëtare përmes programeve, aktiviteteve shkollore dhe shkëmbimeve kulturore për të ruajtur pasurinë gjuhësore dhe trashëgiminë tonë. Përdorimi i platformave arsimore digjitale në funksion të kulturës, letërsisë dhe historisë shqiptare në mbarë botën vlerësohet si mundësi efektive etj.

Gjithashtu, kurrikula e përditësuar mbrohet dhe përkrah identitetin e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë duke u krijuar mundësi nxënësve që të mësojnë gjuhën amtare, historinë, gjeografinë dhe kulturën e tyre. Kjo qasje siguron një bashkëjetesë harmonike dhe respekt ndaj diversitetit kulturor.

2.5. Ndërvarësia dhe lëvizja në kontekstin evropian e më gjerë

Epoka jonë karakterizohet nga ndërvarësia dhe lëvizja në rritje, duke përfshirë aspekte të ndryshme të ndërveprimit global. Vendet tani janë më të lidhura në fusha të tilla si komunikimi, kapitali, arsimi, kultura, migrimi dhe mënyra e jetesës. Në këtë peizazh dinamik, aftësia për të identifikuar dhe për të kuptuar ndryshimet e shpejta dhe të paparashikuara është bërë e domosdoshme, duke filluar nga krizat ekonomike dhe shoqërore, përhapja e sëmundjeve infektive, konfliktet e vazhdueshme etj. Këto sfida nënvizojnë nevojën për një sistem arsimor të përmirësuar, të aftë për të adresuar sfidat dhe kërkesat që formulon zhvillimi. Përshtatja ndaj këtyre ndryshimeve është thelbësore për të rinjtë, pasi ata duhet të zhvillojnë kompetencat, përfshirë respektimin e diversitetit, zgjidhjen paqësore të konflikteve, tolerancën, mirëkuptimin ndërkulturor dhe komunikimin efektiv, për të jetuar dhe vepruar në një botë gjithnjë e më komplekse dhe të ndërlikuar.

2.6. Tranzicioni i gjelbër dhe zhvillimi i qëndrueshëm

Në botën tonë në ndryshim të vazhdueshëm, mirëqenia e brezave të sotëm dhe të ardhshëm përballet me sfida që kërkojnë vëmendje urgjente. Të rinjtë duhet të pajisen me njohuritë dhe kompetencat e nevojshme për të vlerësuar planetin tonë dhe për të ndërmarrë veprime për ta mbrojtur atë.

Kurrikula duhet të edukojë të nxënësit aftësinë dhe prirjen për të ndjekur një mënyrë jetese dhe për të ndërmarrë veprime për zhvillimin e qëndrueshëm. Nxënësit duhet të aftësohen të zbulojnë sfidat e zhvillimit të qëndrueshëm në këndvështrime të ndryshme, që kanë të bëjnë me ndikimet e veprimtarisë së njeriut mbi mjedisin; problemet që lidhen me rritjen e popullsisë, varfërinë dhe urinë; burimet e ripërtëritëshme të energjisë dhe kursimin e saj; ndërmarrjet e biznesit dhe



teknologjitë që kënaqin parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe të tranzicionit të gjelbër.

2.7. Aftësimi profesional dhe aftësitë sipërmarrëse

Kohët e fundit, ekonomia ka njohur kriza të njëpasnjëshme që janë shoqëruar edhe me uljen e burimeve materiale dhe njerëzore të domosdoshme për ringjalljen e saj. Ndryshimet në fushën ekonomike, ndryshimet e profesioneve dhe emigrimi i aftësive profesionale që mundësohen nga rritja e lëvizshmërisë dhe e ndërvarësisë në fushën e komunikimit, të kapitalit, të arsimit, të kulturës, të migrimit, të stilit të jetesës etj. , shtron përpara shkollës detyrën e zhvillimit të kompetencave të shumanshme dhe të frytshme për të studiuar, si dhe të qëndrimeve pozitive për të nxënit gjatë gjithë jetës. Në funksion të plotësimeve të kësaj nevoje është dhe qasja STEM (shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë), një qasje ndërlëndore për të mësuarit dhe për nxënien. Korniza kurrikulare synon të përgatisë nxënësit për karrierën e tyre në fusha të tilla si shkencat kompjuterike, inxhinieri, mjekësi etj. , duke vënë theksin në zhvillimin e të menduarit kritik dhe krijues, në aftësitë për të zbatuar njohuritë dhe strukturat konceptuale të shkencave në fjalë në funksion të projektimit të zgjidhjeve novatore dhe krijuese. Këto aftësi po kërkohen në shumë industri që zhvillimin dhe rritjen e tyre e bazojnë tek teknologjia dhe inovacioni.

Për trajtimin e këtyre nevojave, K. K. -ja thekson me përparësi:

Përdorimin e qasjeve me në qendër nxënësin: Kurrikula e përditësuar thekson fort formimin e nxënësit kompetent. Ajo e përshtat arsimin me nevojat, interesat dhe aftësitë individuale të nxënësve, çka nxit pjesëmarrjen aktive të tij në procesin mësimor, zëvendëson qasjen tradicionale që thekson përvetësimin e përmbajtjen lëndore si qëllim të mësimin me zhvillimin e të menduarit kritik si bazë kryesore për ndërtimin dhe përdorimin e kompetencave nga nxënësit.

Në këtë kontekst, një vend të rëndësishëm ka edhe të nxënit social dhe emocional që synon të zhvillojë mirëqenien emocionale dhe aftësitë sociale të nxënësve, duke kontribuar në suksesin e tyre të përgjithshëm brenda dhe jashtë klasës.

Ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave kyç: Kurrikula e arsimit parauniversitar ka në fokus zhvillimin e tetë kompetencave kyç, të miratuara nga Korniza evropiane e referencës së kompetencave kryesore për të nxënit gjatë gjithë jetës⁽¹⁾. Në themelin e kurrikulës që bazohet në kompetenca qëndron ideja sipas të cilës gjithë sa shtjellohet në dokumentacionin kurrikular dhe në proceset mësimore t'i shërbejnë nxënësit për jetën.

⁽¹⁾Key Competences for Lifelong Learning in the European Schools.

[<https://www.eursc.eu/BasicTexts/2018-09-D-69-en-2.pdf>].



Integrimin e STEM: Qasja STEM do të konsiderohet si qasje efektive që përqendrohet në arritjen e rezultateve të të nxënësve që përcaktohen në fushat STEM (shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë). Ajo nxit ndërtimin dhe demonstrimin e njohurive dhe të kompetencave nga nxënësit, duke mundësuar të menduarin kritik dhe atë kompjuterik, zgjidhjen e problemeve dhe novacionin. Nxënësit do të mësojnë si të përdorin teknologjinë në mënyrë efektive, si të mendojnë në mënyrë kritike për informacionin digjital dhe të respektojnë parimet e qytetarisë digjitale përgjatë ndërveprimit në mjediset online.

Përmirësimin e përmbajtjeve mësimore: Kurrikula përcakton rezultatet e të nxënësve për secilën fushë kurrikulare, arritja e të cilave i jep mundësi nxënësit të ndërtojë gradualisht kompetencat. Në funksion të këtij synimi, programet dhe modulet mësimore integrojnë tema ose çështje ndërkurrikulare bashkëkohore si identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave, zhvillimi i qëndrueshëm, edukimi bazë financiar, ndërgjegjësimi kulturor, qytetaria demokratike dhe sipërmarrja etj. , të cilat do të trajtohen në lëndë të ndryshme nga një perspektivë holistike, duke nxitur të nxënësve ndërlëndor.

Vlerësimin e bazuar në performancën e nxënësve: Metodatat e vlerësimit janë bërë më fleksibël, duke lejuar larmi qasjesh. Përveç testeve kombëtare, nxënësit nxiten t'i demonstrojnë njohuritë dhe kompetencat e fituara përmes projekteve, prezantimeve dhe detyrave praktike. Vlerësimi holistik dikton kalimin përtej testeve të standardizuara për të vlerësuar një gamë më të gjerë aftësish, duke përfshirë zgjidhjen e problemeve, kreativitetin, komunikimin dhe bashkëpunimin. Vlerësimi duhet të paraprihet nga të nxënësve dhe të nxënësve duhet të synojë zgjidhjen e problemeve të botës reale.

Kurrikula e përditësuar thekson **edukimin për karrierë** si pjesë të edukimit për kompetencë, pra për të nxënë gjatë gjithë jetës, ndërkohë që shkolla mundëson këshillimin për karrierë dhe përgatitjen e nxënësve për rrugët e jetës. Ajo i ndihmon ata të eksplorojnë shtigje të ndryshme karriere, të zhvillojnë kompetenca dhe grupime kompetencash për të qenë të aftë të përshtaten me mjediset në ndryshim të tregut të punës.



III. QËLLIMET E SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR

Kurrikula e arsimit parauniversitar krijon kushte dhe mundësi që nxënësit të ndërtojnë, zhvillojnë dhe përdorin njohuri dhe kompetenca që kërkohen në shoqërinë demokratike të dijës, të zhvillohen në mënyrë të pavarur e të gjithanshme, t'i kontribuojnë mirëqenies personale dhe shoqërore, si dhe të përballen në mënyrë konstruktive me dallimet dhe sfidat e jetës. Gjatë arsimit parauniversitar, nxënësit:

- kultivojnë identitetin vetjak, kombëtar dhe përkatësinë kulturore;
- përvetësojnë vlera të përgjithshme kulturore dhe qytetare;
- zhvillohen në aspektet intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike;
- zhvillojnë përgjegjësi ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;
- aftësohen për jetë dhe për punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
- aftësohen për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- zhvillojnë shpirtin e sipërmarrjes;
- përdorin teknologjitë e reja.

Qëllimet e përgjithshme arsimore plotësohen nëpërmjet trajtimit me nxënësit të përmbajtjeve lëndore, të cilat shtjellohen në funksion të rezultateve të të nxënit që duhen arritur nga nxënësit gjatë veprimtarive mësimore. Kjo është detyrë e personelit pedagogjik dhe e aktorëve të tjerë që kontribuojnë për arsimimin dhe edukimin e nxënësve.

IV. PARIMET E PËRGJITHSHME PËR ZHVILLIMIN E KURRIKULËS

Kurrikula e arsimit parauniversitar është e ndërtuar dhe do të funksionojë sipas këtyre parimeve që janë referenca edhe për hartimin e dokumenteve të tjera kurrikulare dhe të proceseve mësimore:

4.1. Konceptimi holistik i kurrikulës që bazohet në kompetenca

Qasja kurrikulare e bazuar në kompetenca integron tri nivele: kurrikulën e planifikuar të paraqitur në dokumentet zyrtare; kurrikulën që zhvillohet e zbatohet në praktikën e shkollës dhe kurrikulën e përvetësuar nga nxënësit. Korniza Kurrikulare përcakton kompetencat kyç dhe konkretizon demonstrimin e tyre nga nxënësit përmes rezultateve kryesore të të nxënit që priten të arrihen prej tyre. Korniza Kurrikulare thekson se kompetencat nuk u mësohen nxënësve nga mësuesi, por ndërtohen dhe demonstrohen nga nxënësit të udhëhequr dhe mbështetur nga mësuesi. Përshkrimi analitik i njohurive, aftësive, qëndrimeve dhe rezultatet e të nxënit me të cilat nxënësit dëshmojnë zotërimin e tyre, shtjellohet në kurrikulat bërthamë të çdo niveli arsimor dhe në programet lëndore.



Në këtë mënyrë sigurohen dhe mundësitë për të çmuar nivelet e arritjeve të nxënësve dhe cilësinë e arsimit të ofruar në nivel lokal dhe kombëtar.

4.2. Gjithëpërfshirja

Gjithëpërfshirja është parim themelor për zhvillimin e kurrikulës. Materializimi i saj kërkon që kurrikula të respektojë dhe t'u përgjigjet nevojave, përvojave, interesave arsimore dhe kulturave të ndryshme të grupeve të nxënësve, pavarësisht nga prejardhja ose karakteristikat e tyre. E udhëhequr nga ky parim, kurrikula ofron zgjedhje që mbajnë parasysh nevojat individuale, stilet e ndryshme të nxënies dhe përvojat e mëparshme të nxënësve si elemente thelbësore për rritjen e rezultateve të tyre mësimore. Në këtë kontekst, Korniza Kurrikulare ka përmirësuar kohën mësimore dhe frekuentimin e shkollës, duke mundësuar:

- mjedis mësimor që mundëson qasje të personalizuar, familjarizim dhe ndihmë për të gjithë nxënësit;
- nxënie dhe pjesëmarrje aktive të nxënësve, përfshirë dhe ata me aftësi ndryshe;
- nxënie që aktivizon përvojat, interesat, kapacitetet dhe stilet e nxënies së nxënësve;
- përfshirjen e nxënësve në planifikimin e mësimit dhe vetëvlerësimin e rezultateve të arrirë.

Duke iu përmbajtur këtij parimi, kurrikula bëhet mjet i fuqishëm për të nxitur krijimin e një mjedisi arsimor gjithëpërfshirës që mbështet suksesin dhe mirëqenien e të gjithë nxënësve.

4.3. Nxënie ndërdisiplinore dhe koherente

Të mësuarit ndërdisiplinor integron njohuri dhe metoda nga fusha dhe/ose disiplina të shumta. Në vend që të fokusohet në një fushë specifike, mësimi ndërdisiplinor nxit eksplorimin e lidhjeve midis disiplinave të ndryshme, për të ofruar një kuptim më të plotë të një teme ose problemi. Kjo qasje pranon se shumë sfida dhe pyetje të botës reale janë komplekse dhe nxënësit mund të përfitojnë nga kombinimi i njohurive nga këndvështrime të ndryshme.

Të mësuarit koherent kërkon organizimin dhe prezantimin e përmbajtjes mësimore në mënyrë të qartë dhe logjike. Ai thekson lidhjet dhe marrëdhëniet midis koncepteve, ideve ose aftësive të ndryshme brenda një lënde të caktuar ose ndërmjet lëndëve. Një përvojë mësimore koherente siguron që nxënësit të kuptojnë sesi pjesët e veçanta të informacionit përshtaten së bashku, duke krijuar një kuptim më të plotë dhe më të strukturuar. Kjo synon të lehtësojë ecurinë e procesit mësimor, duke i lejuar nxënësit të ndërtojnë njohuritë në vijimësi logjike.

E orientuar nga ky parim, Korniza Kurrikulare e strukturon kurrikulën e arsimit parauniversitar në fusha të nxëni, të cilat krijojnë mundësi që rezultatet e të nxënit të arrihen nga nxënësit nëpërmjet



ndërlidhjes së përmbajtjeve mësimore të lëndëve të ndryshme.

4.4. Aftësimi për jetën dhe botën e punës

Arsimi dhe e gjithë kurrikula që është në themel të tij, duhet t'i shërbejnë aftësimin të nxënësve për jetën, t'i pajisin ata me dije, aftësi, shprehi praktike e qëndrime të domosdoshme, për të përballuar me sukses nevojat e punësimit dhe sfidat e jetës së përditshme, për të siguruar të nxënësit e vazhdueshëm në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Shkolla duhet të orientojë zhvillimin e karrierës së nxënësve dhe t'i edukojë me ndjenjën e vetëbesimit, respektit për çdo lloj pune dhe profesioni.

4.5. Integrimi i teknologjisë në arsim

Integrimi i teknologjisë në arsim konsiderohet tani parim themelor kurrikular, pasi zbatimi i tij po transformon mënyrën se si nxënësit mësojnë dhe mësuesit zhvillojnë mësim. Kurrikula që materializon këtë parim, u krijon nxënësve mundësi që të pajisen me njohuritë dhe kompetencat e duhura për të lundruar me mjeshtëri në peizazhin digjital, të angazhohen aktivisht në shoqëritë e drejtuar nga teknologjia dhe të përgatiten për arsimimin e mëtejshëm dhe profesionet e së ardhmes. Në qendër të këtij parimi është përdorimi strategjik i Teknologjisë Arsimore (EdTech) për të përmirësuar rezultatet e të nxënësit dhe për të ndihmuar nxënësit të ndërtojnë e përdorin kompetencën digjitale. Kërkesat në tregun e punës kushtëzojnë aftësimin e nxënësve për të përvetësuar aftësitë bazë digjitale, si dhe gjuhët e programimit, të menduarin kompjuterik etj. Për këtë është thelbësore të adresohen edhe çështjet që lidhen me aksesin në teknologji, barazinë etj.

4.6. Bashkëpunimi dhe partneriteti

Në rrethanat ku arsimi është përpykje e përbashkët e shkollës, shoqërisë dhe komuniteteve, krijimi dhe ruajtja e partneriteteve janë thelbësore për të arritur suksesin dhe për të siguruar mjedis arsimor të pasur, miqësor dhe të sigurt. Në këtë kontekst, kurrikula kujdeset që të krijohen lidhje të forta me prindërit, organizatat jo-qeveritare, bizneset lokale dhe institucionet qeveritare, lokale e qendrore. Ky bashkëpunim shkon nga përfshirja e prindërve në vendimet shkollore, deri te krijimi i programeve shkollore që pasqyrojnë nevojat dhe potencialet e komunitetit lokal. Kur prindërit, kompanitë dhe organizatat jo-qeveritare ndihmojnë në krijimin dhe mbështetjen e programeve arsimore dhe krijohet mjedis më i pasur dhe më efikas për zhvillimin e nxënësve.

4.7. Autonomia dhe përgjegjshmëria

Autonomia dhe përgjegjshmëria janë parime kurrikulare kyç për të siguruar një sistem arsimor të përshtatshëm dhe të suksesshëm. Autonomia e lejon institucionin arsimor të marrë vendime që



adresojnë nevojat dhe sfidat e veçanta të komunitetit shkollor, nëpërmjet programeve të personalizuara, projekteve dhe nismave të reja.

Përgjegjshmëria lidhet me detyrimet e shkollës ndaj nxënësve dhe komunitetit. Ajo siguron vlerat si integriteti, kujdesi ndaj nevojave të nxënësve dhe përgatitjen e tyre për të qenë pjesë e shoqërisë së ardhshme.

Autonomia dhe përgjegjshmëria janë dy parime kyç për funksionimin e një sistemi arsimor efektiv që mundësojnë lirinë dhe përgjegjësinë e institucionit arsimor për administrimin dhe krijimin e një mjedisi të përshtatshëm mësimor. Të dyja parimet kanë ndikim të rëndësishëm në cilësinë dhe rezultatet e arsimit dhe ndihmojnë që institucioni arsimor të kthehet në qendër të risive dhe të zhvillimit.

4.8. Ndërgjegjësimi global dhe kulturor:

Realiteti sot kërkon një njohje në rritje të rëndësisë së kompetencës globale dhe ndërgjegjësimit kulturor. Mësuesit duhet t'i përgatisin nxënësit që të ecin dhe të kenë sukses në një botë të ndërlidhur dhe të ekspozuar ndaj perspektivave të ndryshme dhe çështjeve globale. Edukimi global dhe edukimi për qytetari globale, janë përparësi e politikës së UNESCO-s dhe të Këshillit të Evropës. Koncepti kyç i këtij edukimi është koncepti i ndërvarësisë. Edukimi global dhe edukimi për qytetari globale kërkojnë shikimin e botës si një sistem pjesësh, instrumentesh, mekanizmash që kushtëzojnë njëri-tjetrin.

4.9. Përmirësimi i vazhdueshëm i kurrikulës

Zhvillimi dhe zbatimi i kurrikulës në arsimin parauniversitar duhet të jetë një proces i vazhdueshëm i bazuar në studime, vlerësime, vetëvlerësime dhe reflektime për përmirësim. Përmirësimi i vazhdueshëm i kurrikulës nënkupton fleksibilitet në përshtatjen me tendencat e reja arsimore, adresimin e nevojave në zhvillim dhe përpjekjen për efektivitet të mëtejshëm në rezultatet arsimore.



V. KOMPETENCAT KYÇE EUROPIANE DHE REZULTATET E TË NXËNIT QË I DËSHMOJNË ATO NË PËRFUNDIM TË APU-SË⁽²⁾

5.1. Kuptimi për kompetencat kyçe

Kompetencat kyçe janë ato kompetenca që duhet të zhvillojnë dhe të ndërtojnë të gjithë të rinjtë, në mënyrë që të formojnë aftësitë e tyre të ardhshme, të identifikuar si të nevojshme për të lulëzuar dhe për të pasur sukses në shoqërinë e shekullit të XXI, me qëllim:

- *përbushjen dhe zhvillimin personal,*
- *punësimin,*
- *përfshirjen sociale,*
- *stilin e qëndrueshëm të jetesës,*
- *jetën e suksesshme në një shoqëri paqësore,*
- *kujdesin shëndetësor*
- *qytetarinë aktive.*

Kompetencat kyçe zhvillohen në një perspektivë të të mësuarit gjatë gjithë jetës përmes përvojave jetësore, të mësuarit formal, joformal dhe informal në të gjitha kontekstet, në mjedise të ndryshme, në familje, në shkollë, në vendin e punës, në komunitet e më gjerë.

Duke fituar mirëkuptimin e përgjithshëm shoqëror si kompetenca që nevojiten për sot dhe për të ardhmen, ato janë kthyer në një instrument referimi për vendimmarrësit në fushën e arsimit dhe të trajnimit. Në përbushje të qëllimeve arsimore kurrikula krijon mundësi që nxënësi t'i fitojnë gradualisht kompetencat kyçe, dhe t'i zbatojnë ato në përfundim të arsimit parauniversitar. Këto kompetenca janë:

1. *Kompetenca e komunikimit në gjuhën amtare;*
2. *Kompetenca e komunikimit në gjuhë të huaja;*
3. *Kompetenca në matematikë, shkencë, teknologji dhe inxhinieri;*
4. *Kompetenca digjitale;*
5. *Kompetenca personale, shoqërore dhe e të nxënit;*
6. *Kompetenca qytetare;*
7. *Kompetenca e sipërmarrjes;*
8. *Kompetenca për vetëdijen dhe shprehjen kulturore.*

⁽²⁾ *Key Competences for Lifelong Learning in the European Schools.*
[<https://www.eursc.eu/BasicTexts/2018-09-D-69-en-2.pdf>].



Kompetenca kuptohet si kapaciteti i individit i cili përmes të nxënit integron njohuri, aftësi e qëndrime dhe i demonstroi ato kur trajton situatat mësimore dhe ato jetësore. Në vijim, përshkruhet kuptimi i përgjithshëm dhe rezultatet e të nxënit për çdo kompetencë kyçe⁽³⁾.

5.2. Kompetenca e komunikimit në gjuhën amtare

Përshkrimi i kompetencës

Kompetenca e komunikimit në gjuhën amtare kuptohet si *kapaciteti i individit*⁽⁴⁾ për të identifikuar, kuptuar, shprehur, krijuar dhe interpretuar koncepte, ndjenja, fakte dhe opinione me gojë dhe me shkrim, duke përdorur materiale vizuale, tinguj (audio dhe/ose digjitale) nëpër disiplina dhe kontekste të ndryshme. Ajo nënkupton aftësinë për të komunikuar dhe për t'u lidhur me të tjerët në mënyrë efektive, të përshtatshme dhe krijuese. Zhvillimi i kuptimit, interpretimi dhe përdorimi i informacionit të shtypur ose virtual përbën bazën për nxënien dhe ndërveprimin e mëtejshëm gjuhësor. Në varësi të kontekstit, kompetenca mund të zhvillohet në gjuhën amtare, në gjuhën e shkollimit dhe në gjuhën zyrtare.

Rezultate kryesore të të nxënit

Për të dëshmuar kompetencën e komunikimit në gjuhën amtare, nxënësi:

- komunikon si dëgjues, folës, lexues dhe shkruar në situata të ndryshme dhe për qëllime të ndryshme.
- monitoron dhe përshtat komunikimin e tij me kërkesat e situatës;
- përdor dhe dallon lloje të ndryshme tekstesh, përfshirë tekstet digjitale;
- kërkon, mbledh dhe përpunon informacione duke përdorur mjete ndihmëse;
- formulon dhe shpreh argumente me gojë dhe me shkrim në përshtatje me kontekstin;
- ndërton identitetin e tij kulturor dhe gjuhësor, si dhe kontribuon në transmetimin dhe pasurimin e trashëgimisë gjuhësore amtare;
- përdor gjuhën për të krijuar dhe për të vlerësuar krijime artistike, të cilat shprehin emocionet, përjetimet dhe idetë e tij.

⁽³⁾ Shtjellimi më i hollësishëm i kuptimit të njohurive, aftësive dhe qëndrimeve që integron çdo kompetencë do të ofrohet në dokumentet që burojnë nga Korniza Kurrikulare.

⁽⁴⁾ Togfjalëshi "*kapaciteti i individit*" kuptohet si njohuri, aftësi e qëndrime që ai i ka ndërtuar tashmë dhe i demonstroi gjatë procesit të nxënies, në lëndë apo veprimtari të ndryshme mësimore.



5.3. Kompetenca e komunikimit në gjuhë të huaja

Përshkrimi i kompetencës

Kompetenca e komunikimit në gjuhë të huaja kuptohet si kapacitet i individit për të përdorur për komunikim gjuhë të ndryshme, në mënyrë të përshtatshme dhe efektive. Ajo bazohet në aftësinë për të kuptuar, për të shprehur dhe për të interpretuar konceptet, mendimet, ndjenjat, faktet dhe opinionet me gojë dhe me shkrim (të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit) në kontekste shoqërore dhe kulturore, sipas dëshirave ose nevojave të dikujt. Sipas rastit, ajo mund të përfshijë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave të gjuhës amtare.

Rezultate kryesore të të nxënësit

Për të dëshmuar kompetencën e

komunikimit në gjuhë të huaj, nxënësi:

- kupton mesazhet e folura;
- fillon, ndjek dhe përfundon bisedat;
- lexon, kupton dhe prodhon tekste, përfshirë tekstet digjitale të përshtatshme për nevojat e tij;
- përdor mjetet në mënyrë të përshtatshme dhe angazhohet me gjuhët në mënyrë formale, joformale dhe informale;
- monitoron dhe përshtat komunikimin e tij me kërkesat e situatës;
- respekton gjuhën amtare të personave që u përkasin minoriteteve;
- vlerëson se si ndryshimet kulturore ndikojnë në përdorimin dhe komunikimin e gjuhës.

5.4. Kompetencat në matematikë, shkencë, teknologji dhe inxhinieri

Përshkrimi i kompetencës

a. *Kompetenca në matematikë* kuptohet si kapacitet i individit për të ndërtuar dhe për të zbatuar mendimin matematik në zgjidhjen e problemeve në situata të jetës së përditshme. Ndërtimi i saj nga nxënësi kërkon zotërimin prej tij të njohurive për numrat dhe veprimet me to, me theks aftësitë, proceset, veprimtaritë dhe aftësinë për të përdorur në mënyra të ndryshme mendimin matematik (logjik, sasior dhe hapësinor) dhe modelimet

Rezultate kryesore të të nxënësit

Për të dëshmuar kompetencat në matematikë, shkencë, teknologji dhe inxhinieri, nxënësi:

- zbaton parimet dhe proceset themelore matematikore në kontekstet e përditshme të jetës reale, përfshirë aftësitë financiare;
- ndjek dhe vlerëson organizimin logjik të argumenteve;
- arsyeton matematikisht;
- kupton vërtetimin matematik;



(formula, modele, ndërtime, grafikë dhe tabela).

b. Kompetenca në shkencë kuptohet si kapaciteti i individit për të integruar njohuritë dhe metodologjitë me të cilat shpjegohet bota natyrore, me qëllim identifikimin e pyetjeve dhe nxjerrjen e përfundimeve të bazuara në prova. Kompetencat në teknologji dhe inxhinieri lejojnë zbatime të njohurive dhe metodologjive në përgjigje të ideve ose nevojave që perceptohen nga njerëzit. Kompetenca në shkencë, teknologji dhe inxhinieri mundëson kuptimin e ndryshimeve që vijnë nga veprimtaria e njerëzve dhe të përgjegjësisë si qytetar.

- komunikon me gjuhën matematike;
- përdor mjete ndihmëse të përshtatshme, duke përfshirë të dhënat statistikore dhe grafikët;
- përdor dhe trajton mjetet dhe pajisjet teknologjike;
- hulumton natyrën përmes eksperimenteve të kontrolluara;
- përdor dhe trajton të dhëna shkencore për të arritur një qëllim, për të marrë një vendim ose për të nxjerrë një përfundim bazuar në prova;
- njeh karakteristikat thelbësore të kërkimit shkencor;
- komunikon përfundimet dhe arsyetimet që çuan në një përfundim të bazuar në prova.

5.5. Kompetenca digjitale

Përshkrimi i kompetencës

Kompetenca digjitale kuptohet si kapaciteti i individit për të përdorur dhe për të kuptuar teknologjinë dhe mjedisin digjital në mënyrë efektive dhe të përgjegjshme. Ajo përfshin një gamë të gjerë të aftësive, duke filluar nga shkrim-leximi digjital, kërkimi dhe vlerësimi i informacionit, krijimi i përmbajtjeve digjitale, respektimi i parimeve të qytetarisë digjitale, mbrojtja e të dhënave, zgjidhja e

Rezultate kryesore të të nxënës

Për të dëshmuar kompetencën digjitale, nxënësi:

- përdor, filtron, përpunon dhe vlerëson përmbajtje digjitale;
- interpreton dhe analizon të dhënat për të nxjerrë përfundime dhe për të marrë vendime të mirë informuara;
- identifikon dhe zgjidh probleme të ndryshme duke përdorur teknologjinë dhe mjediset digjitale;
- krijon, programon dhe shpërndan përmbajtje digjitale;
- menaxhon dhe mbron informacionin, përmbajtjen, të dhënat dhe identitetet digjitale;



- problemeve dhe të qenit koherent me teknologjitë e reja.
- përdor mjete digjitale për të prodhuar, për të paraqitur dhe për të kuptuar informacione komplekse;
 - njih dhe angazhohet në mënyrë efektive me softuerët dhe pajisjet;
 - kupton dhe përdor inteligjencën artificiale për të analizuar dhe për të interpretuar të dhënat, për të zhvilluar dhe për të trajtuar modele parashikuese, si dhe për të zgjidhur probleme të ndryshme;
 - përdor teknologjinë digjitale për të krijuar dhe për të bashkëpunuar me të tjerët drejt qëllimeve personale, sociale ose tregtare.

5.6. Kompetenca personale, shoqërore dhe e të nxënit


Përshkrimi i kompetencës

Kompetenca personale, shoqërore dhe e të nxënit kuptohet si kapaciteti i individit për të reflektuar për veten, për të menaxhuar në mënyrë efektive kohën dhe informacionin, për të punuar me të tjerët në mënyrë konstruktive, për të qenë i gatshëm, për të menaxhuar nxënien dhe karrierën personale. Ajo përfshin aftësinë për të mbështetur mirëqenien fizike dhe emocionale, aftësinë për të menaxhuar konfliktin, aftësinë për të zhvilluar kompetencat personale dhe aftësinë për të gjetur

Rezultate kryesore të të nxënit

Për të dëshmuar kompetencën personale, shoqërore dhe të nxënies, nxënësi:

- identifikon përparësitë dhe dobësitë personale, përparon duke u mbështetur në përparësitë e tij dhe punon për kapërcimin e dobësive/mangësive;
- organizon të nxënit, fokusohet dhe vendos qëllime;
- vlerëson në mënyrë kritike punën e tij duke iu referuar qëllimeve fillestare;
- motivon dhe vlerëson veten;
- mëson dhe punon në mënyrë të pavarur dhe në bashkëpunim;
- shpreh dëshirë dhe vlerëson nevojën për të nxënit gjatë gjithë jetës;
- komunikon në mënyrë konstruktive dhe bashkëpunon në ekip;
- menaxhon në mënyrë efektive burimet, kohën,



rrugë të ndryshme për zhvillimin e tij personal.

njerëzit, karrierën, mjedisin dhe ndërveprimet e tij me shoqërinë;

- negocion në mënyrë efektive, kupton ndjenjat, mendimet dhe perspektivat e të tjerëve;
- menaxhon stresin, pasiguritë dhe zgjidh konfliktet ndërpersonale në mënyrë konstruktive;
- kupton dhe vlerëson mënyrën e jetës së shëndetshme.

5.7. Kompetenca qytetare

Përshkrimi i kompetencës


Kompetenca qytetare kuptohet si kapaciteti i individit që integron njohuri dhe aftësi për të marrë pjesë dhe për të vepruar si qytetar i përgjegjshëm në shoqëri, duke u bazuar në njohjen e ngjarjeve dhe zhvillimeve kryesore të historisë kombëtare, evropiane dhe botërore, në kuptimin kritik të strukturave shoqërore, ekonomike dhe politike si dhe në kuptimin e koncepteve të zhvillimit dhe qëndrueshmërisë globale.

Përveç këtyre kjo kompetencë përfshin të kuptuarin e vlerave të përbashkëta Evropiane, vetëdijen për diversitetin dhe identitetet kulturore, vetëdijen për politikën lëvizjet shoqërore dhe për sistemet e qëndrueshme, në mënyrë të veçantë ndryshimet klimatike dhe demografike në nivel global dhe

Rezultate kryesore të nxënësve

Për të dëshmuar kompetencën qytetare, nxënësi:

- angazhohet në mënyrë efektive me të tjerët në çështjet publike;
- tregon solidaritet dhe interes në zgjidhjen e problemeve në nivel shkollë, komuniteti e më gjerë;
- merr pjesë në mënyrë konstruktive në aktivitetet e komunitetit;
- vlerëson diversitetin dhe demonstroi tolerancë, mirëkuptim, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve;
- merr pjesë në proceset demokratike të vendimmarrjes në të gjitha nivelet (p. sh. në familje, në shkollë, në komunitet lokal/aktivitete të lagjes, si dhe në proceset e politikave lokale dhe shtetërore);
- demonstroi vlerat dhe parimet e të drejtave të njeriut në jetën e përditshme (p. sh. respekti i dinjitetit personal, luftimi i paragjyqimeve dhe diskriminimit të të gjitha llojeve; promovimi i barazisë gjinore etj.);
- menaxhon dhe zgjidh konfliktet në mënyrë konstruktive dhe të paanshme;
- demonstroi sjellje etike dhe të përgjegjshme ndaj



shkaqet e tyre.

mjedisit dhe kontribuon në qëndrueshmërinë mjedisore.

5.8. Kompetenca e sipërmarrjes

Përshkrimi i kompetencës

Kompetenca e sipërmarrjes kuptohet si kapaciteti i individit për të vepruar sipas mundësive dhe ideve dhe për t'i shndërruar ato në vlera për vete dhe të tjerët. Ajo bazohet në zhvillimin e aftësive krijuese, të mendimit kritik, në zgjidhjen e problemeve, në iniciativën dhe në këmbënguljen për të punuar në mënyrë bashkëpunuese, për të planifikuar dhe për të menaxhuar projekte që kanë vlerë kulturore, sociale ose tregtare.

Rezultate kryesore të të nxënit

Për të dëshmuar kompetencën e sipërmarrjes, nxënësi:

- mendon në mënyrë strategjike dhe zgjidh problemin;
- përdor imagjinatën e tij gjatë proceseve krijuese dhe novatore;
- menaxhon projektet, planifikon, organizon, drejton dhe delegon;
- merr vendime financiare për koston dhe vlerën si dhe çmon koston e shndërrimit të një ideje në një aktivitet që krijon vlerë;
- planifikon, merr dhe vlerëson vendimet financiare;
- komunikon në mënyrë efektive dhe negocion me të tjerët;
- përballet me pasigurinë, paqartësinë dhe rrezikun për vendime që ndërmerr;
- identifikon pikat e forta dhe kufizimet;
- punon në mënyrë të pavarur si dhe bashkëpunon me të tjerët.

5.9. Kompetenca për vetëdijen dhe shprehjen kulturore

Përshkrimi i kompetencës

Kompetenca për vetëdijen dhe shprehjen kulturore kuptohet si kapaciteti i individit që i lejon të kuptojë dhe të respektojë mënyrën sesi idetë dhe kuptimet shprehen dhe komunikohen në mënyrë krijuese në kultura të ndryshme, përmes mjeteve dhe formave të ndryshme kulturore. Ajo përfshin kuptimin, zhvillimin, shprehjen e ideve, të ndjenjës së përkatësisë

Rezultate kryesore të të nxënit

Për të dëshmuar kompetencën për vetëdijen dhe shprehjen kulturore, nxënësi:

- njeh, respekton dhe çmon kulturën e tij si dhe vlerat, besimet dhe kulturat e të tjerëve;
- shpreh dhe interpreton idetë, përvojat, emocionet figurative dhe abstrakte me ndjeshmëri në arte të ndryshme dhe forma




ose të rolit të personit në shoqëri, në mënyra dhe kontekste të ndryshme. Kjo kompetencë përfshin njohuri për kulturat vendore, kombëtare, rajonale, europiane dhe globale, duke përfshirë gjuhën, trashëgiminë dhe traditat kulturore si dhe mënyrën se si të gjitha këto mund të ndikojnë tek njëra-tjetrën dhe në idetë e formësimin e individëve.

- të tjera kulturore;
- shijon dhe vlerëson veprat e artit;
- shpreh veten në medie të ndryshme, duke përdorur dhe përmirësuar kapacitetin personal;
- identifikon dhe realizon mundësitë për të shprehur vlera personale, sociale ose tregtare nëpërmjet arteve dhe formave të tjera kulturore;
- angazhohet në proceset krijuese individualisht dhe kolektivisht.

Të gjitha kompetencat janë njëlloj të rëndësishme, ato ndërlidhen me njëra – tjetrën ku aspekte thelbësore të një fushe mbështesin ndërtimin e kompetencave në fusha të tjera, çka do të thotë se ato ndihmojnë reciprakisht në trajtimin e situatave në fusha të ndryshme. Aftësi të tilla si aftësia për të menduar në mënyrë kritike dhe krijuese, për të zgjidhur probleme, për të punuar në ekip, për të komunikuar, për të negociuar, dhe aftësitë analitike dhe ndërkulturore i gjen të mishëruara në të gjitha kompetencat

Mënyra si ndihmohen nxënësit të ndërtojnë kompetencat varet nga qasjet pedagogjike që ndërmerren në varësi të konteksteve konkrete të IA-së. Të gjithë nxënësve duhet t'u mundësohet zhvillimi i plotë i potencialit të tyre, përmes sigurimit të një arsimit cilësor, ofrimit të një mësimdhënie – nxënie cilësore dhe të efektshme, zhvillimit të mëtejshëm fillestar dhe të vazhduar të arsimit dhe trajnimit profesional, si dhe përmes modernizimit të arsimit të lartë.



VI. STRUKTURA, NIVELET E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DHE VEÇORITË

6.1. Struktura e arsimit parauniversitar

Sistemi arsimor parauniversitar mbështetet në traditën pozitive të arsimit, e cila funksionon në zbatim e në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionin përkatës në fuqi, është i harmonizuar me Klasifikimin e Standardit Ndërkombëtar të Arsimit (KSNA), si dhe zhvillohet në respekt të vlerave të përbashkëta të sistemeve arsimore bashkëkohore.

Sistemi arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë

STRUKTURA E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR NË SHQIPËRI					
Klasifikimi Ndërkombëtar Standard i Arsimit (KNSA)	KSNA 0		KSNA 1	KSNA 2	KSNA 3
Nivelet e edukimit në sistemin arsimor formal	Arsimi Parashkollor (Mosha 0 – 6 vjeç)		Arsimi Fillor Klasat I – V (Mosha 6 – 11 vjeç)	Arsimi i Mesëm i Ulët Klasat VI – IX (Mosha 11 – 15 vjeç)	Arsimi i Mesëm i Lartë Klasat X – XII/XIII (Mosha 15 – 18/19 vjeç)
Llojet e edukimit	Edukimi parashkollor (0 – 5 vjeç)	Viti përgatitor (klasa përgatitore ose grupi i tretë në kopsht) (5 – 6 vjeç)	- Shkollë e arsimit fillor - Shkollë e arsimit bazë - Shkollë speciale - Shkollë e pakicave kombëtare - Shkollë artistike	- Shkollë e arsimit bazë - Shkollë speciale - Shkollë e pakicave kombëtare - Shkollë artistike	- Gjimnazi - Shkollë me drejtim të orientuar - Gjimnazi gjuhësor - Shkollë profesionale
Provimet Kombëtare			Vlerësimi i arritjeve të nxënësve në Arsimin Fillor (VANAF)	Provimet kombëtare të Arsimit Bazë (PKAB)	Matura Shtetërore (MSH)
Nivelet e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve				1	4



Përgjatë niveleve të arsimit formal, nxënësit përgatiten për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe për botën e punës në epokën e dijes së bazuar në digjitalizim. Në raport me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, Korniza Kurrikulare u referohet 2 niveleve formale të arsimit të përgjithshëm dhe 4 niveleve të arsimit dhe formimit profesional. Korniza Kurrikulare është si një dritare e hapur për të nxënësit gjatë gjithë jetës dhe për arsimimin e të rriturve. Prandaj në të gjitha nivelet e kurrikulës dhe në të gjitha fushat e të nxënësit theksohen mundësitë që u ofrohen nxënësve për të arritur kualifikimet kombëtare të bazuara në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve.

6.2. Nivelet arsimore dhe veçoritë e tyre

Arsimi parauniversitar integron:

- ✓ edukimin parashkollor që u ofrohet fëmijëve të moshës 0 - 5 vjeç si dhe arsimi përgatitor 5 - 6 vjeç.
- ✓ arsimin fillor që ofrohet nga klasa e parë deri në klasën e pestë;
- ✓ arsimin e mesëm të ulët që ofrohet nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë;
- ✓ arsimin e mesëm të lartë që ofrohet në:
 - gjimnaz, arsim i mesëm i orientuar, gjimnaz gjuhësor i cili mundësohet në klasën e dhjetë deri në klasën e dymbëdhjetë;
 - arsimin e mesëm profesional e cila mundësohet në klasën e dhjetë deri në klasën e trembëdhjetë

Në kontekstin e arsimit parauniversitar, interesi i nxënësit është parësor. Ky sistem mbrohet dhe promovon të drejtat e liritë e njeriut në përgjithësi dhe të drejtat e fëmijëve në veçanti. Nxënësve dhe punonjësve arsimorë u ofrohet mbrojtje nga çdo formë veprimi ose mosveprimi që mund t'u shkaktojë diskriminim, dhunë, keqtrajtim ose dëm moral, sigurohet përfshirja e nxënësve, si dhe e drejta për arsimim cilësor e shanse të barabarta për arsimim. Institucionet e arsimit parauniversitar u ofrojnë përkujdesje të posaçme nxënësve me aftësi të kufizuara dhe atyre me vështirësi në të nxënë.

Edukimi parashkollor

Edukimi parashkollor është niveli i parë arsimor gjatë të cilit fëmijët edukohen në institucione parashkollore (kopshte). Kjo moshë paraqet një periudhë të zhvillimit të shpejtë fizik, njohës, emocional dhe social të fëmijëve. Duke konsideruar rëndësinë e kësaj periudhe, ekspozimi i fëmijëve ndaj proceseve të thjeshta të nxënies nxit kërkshërinë për veten, për shoqërinë, natyrën, kulturën dhe teknologjitë e reja. Synimi i punës edukative është zhvillimi i krijimtarsisë dhe i



entuziazmit për përvojat e reja dhe situatat jetësore. Fëmijët ndihmohen që të zhvillojnë aftësitë dhe shprehjet e komunikimit në gjuhën amtare në situata të thjeshta të përditshme, aftësitë e përqendrimit dhe ato shoqërore bazike. Në këtë nivel, u kushtohet vëmendje e veçantë zhvillimit fizik nëpërmjet veprimtarive fizike, përvojave që rrisin vetëdijen e fëmijëve për mbrojtjen e tyre fizike dhe kujdesin për shëndetin.

Përmbajtjet e veprimtarive mësimore gjatë edukimit parashkollor duhen përzgjedhur dhe realizuar të tilla që fëmijët, në përfundimin e nivelit:

- të njohin dhe kuptojnë veten dhe të tjerët përreth;
- të kuptojnë dhe pranojnë atë që është ndryshe ose e ngjashme tek bashkëmoshatarët etj. ;
- të krijojnë sjellje modeste me të cilën përcjellin tolerancë, mirëkuptim, bashkëpunim etj. ;
- të shprehin ndjenjat vetjake dhe të dallojnë mënyrat e shprehjes së tyre nga të tjerët;
- të përdorin gjuhën amtare për të shprehur ndjenjat dhe mendimet e tyre;
- të zotërojnë shprehi të thjeshta komunikuese dhe artistike;
- të përdorin njohuri të thjeshta në jetën e përditshme;
- të kujdesen në mënyrë të pavarur për higjienën vetjake dhe mjedisin përreth.

Viti përgatitor

Në vitin përgatitor fëmijët e moshës 5 – 6 vjeç edukohen në institucione parashkollore (kopshtegrupi i tretë) dhe në shkollat e arsimit bazë (klasa përgatitore). Klasat përgatitore frekuentohen nga fëmijë 5 vjeç të cilët nuk kanë ndjekur arsimin parashkollor. Është pikërisht ky kriter, ai që dallon grupet e treta të kopshteve nga klasa përgatitore, sepse të dyja frekuentohen nga fëmijë të moshës 5-6 vjeçare, por në klasat përgatitore do të regjistrohen fëmijët 5 vjeçar që nuk kanë ndjekur kopshtin. Në përfundimin e kësaj klase, përmbajtjet mësimore që fëmijët trajtojnë me ndihmën e mësuesve të mundësojnë, që ata:

- të njohin elementet bazë të leximit, të shkrimit dhe të njësimit me numra, me synim integrimin në arsimin e detyruar;
- të njohin elementet e shkronjave dhe strukturën e një teksti të thjeshtë, duke shfrytëzuar fotografi / vizatime dhe analizuar elementet e një pikturë;
- të zhvillojnë ndjeshmërinë dhe elementët e sferës emocionale;
- të përjetojnë përvoja edukative nëpërmjet lojës-punës-mësimi, çka rrit gatishmërinë e tyre për shkollim fillor dhe për jetën.



Arsimi Fillor (AF): Klasat I-V

Në arsimin fillor përvojat mësimore i përshtatin nxënësit me një formë më të sistemuar të nxënies, nëpërmjet punës, mësimi dhe i aftësojnë ata të bëjnë dallimin mes lojës dhe detyrës. Procesi mësimor i ndihmon nxënësit të përmirësojnë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme të gjuhës amtare dhe të një gjuhe tjetër. Ai realizohet në mënyrë të integruar, që të kuptohet mirë marrëdhënia e nxënësve me mjedisin natyror dhe atë të krijuar nga njerëzit. Njëherazi, nxënësve u krijohen mundësi të ndërtojnë njohuritë e para për botën digjital edhe të njohin e zbatojnë rregulla e kufizime për përdorimin e TIK-ut, në një mjedis mësimor të sigurt dhe efektiv.

Në këtë nivel arsimor, krahas arsimit të përgjithshëm, nxënësit me talente mund të vijojnë institucionet me drejtim të orientuar artistik që themelohen dhe funksionojnë në bazë të kurrikulave dhe legjislacionit të veçantë për to. Në këto institucionet, nxënësit marrin bazat elementare që i orientojnë për drejtime të ndryshme artistike. Procesi mësimor organizohet, lehtësohet dhe bashkërendohet nga mësuesi i klasës, i ndihmuar sipas nevojës, nga asistenti dhe mësuesi i specializuar i lëndës.

Në kontekstin e përgjithshëm, përmbajtjet dhe veprimtaritë mësimore, si dhe metodologjitë e të nxënësve t'i ndihmojnë nxënësit që:

- të përvetësojnë aftësitë bazë të leximit- shkrimit, njehsimi dhe të marrin njohuri për kodimin;
- të përdorin në jetën e përditshme gjuhën amtare standarde, të folur dhe të shkruar;
- të kenë ndërtuar dhe të përdorin konceptet fillestare të një gjuhe të huaj;
- të kenë ndërtuar bazat e zhvillimit njohës, socio-emocional dhe motorik;
- të përdorin simbole e të bëjnë veprime matematike për zgjidhjen e problemeve të thjeshta;
- të njohin të drejtat e tyre dhe të respektojnë të drejtat e të tjerëve;
- të mbajnë higjienën dhe të shmangin faktorët e dëmshëm për shëndetin vetjak dhe të tjerëve;
- të njohin mjedisin dhe të veprojnë me kujdes në mbrojtje të tij
- të përdorin mjete të thjeshta të komunikimit artistik;
- të zotërojnë e kontrollojnë funksionet trupore në veprimtaritë dhe lojërat e ndryshme fizike;
- të njohin dhe respektojnë veçoritë kulturore të individëve dhe të grupeve të tjera;
- të mirëkuptojnë dhe të bashkëpunojnë me të tjerët;
- të çmojnë të nxënësve si bazë për fitimin e njohurive të reja dhe zhvillimin e aftësive.



Arsimi i Mesëm i Ulët (AMU): Klasat VI-IX

Është niveli ku nxënësve u paraqiten sfida të reja për zhvillimin njohës, shpirtëror, shoqëror, etik dhe fizik. Nxitet më tej kurioziteti për të fituar njohuri, aftësi dhe qëndrime, si bazë për nivelet më të larta arsimore. Brenda e të nxënësve pasurohet me përvoja të larmishme (p. sh. , situata që kombinojnë të menduarin abstrakt me veprimet konkrete, kontakti me realitetin konkret dhe atë virtual etj.), që nxënësit të identifikojnë fushat e interesit dhe çka u pëlqen. Nxënësit vijojnë të përsosin më tej kompetencën e komunikimit në gjuhën amtare standarde. Qasja STEM u mundëson atyre të përvetësojnë e përdorin konceptet shkencore dhe teknike përmes metodave që nxitin zgjidhjen e situatave problemore, komunikimin e ideve, gjetjen dhe shfrytëzimin e burimeve digjitale gjatë procesit mësimor (portalet digjitale mësimore, web faqet shkencore, mediat e besueshme etj.), si dhe të sistemojnë dhe ruajnë materialeve dhe detyra mësimore në formate elektronike etj. Bazuar në arritjet e siguruara më parë, përmbajtjet mësimore dhe metodologjitë e të nxënësve të sigurojnë që nxënësit të ndihmohen:

- të konsolidojnë aftësitë për të folur, lexuar dhe shkruar saktë, duke bërë funksionale dhe të qëndrueshme tema të ndryshme të informacionit, kulturës, shkencës dhe të teknologjisë;
- të lexojnë, të shkruajnë, të dëgjojnë e të komunikojnë sakte në një gjuhë të huaj dhe të kenë ndërtuar dhe të përdorin konceptet fillestare në një gjuhë të huaj të dytë.
- të shfrytëzojnë imagjinatën për komunikimin e ideve;
- të kryejnë veprimet bazë aritmetike (mbledhje, zbritje, shumëzim, pjesëtim) të zbatojnë të menduarit algjebrik, parimet gjeometrike dhe të zhvillojnë aftësitë për zgjidhjen e problemeve;
- të shfrytëzojnë me efikasitet kohën;
- të gjejnë dhe përdorin burime informimi si bibliotekat elektronike, motorët e kërkimit, mediat e besueshme etj. ;
- të aftësohen më tej të kodojnë dhe përdorin TIK-un;
- të ndjekin një stil jetese të shëndetshme;
- të kuptojnë marrëdhënien ndërmjet njeriut dhe mjedisit dhe të zhvillojnë përgjegjësinë ndaj tij;
- të vlerësojnë shumëllojshmërinë kulturore, etnike, fetare dhe të demonstrojnë tolerance dhe respekt ndaj diversitetit;
- të demonstrojnë vlerat dhe parimet e të drejtave të njeriut në jetën e përditshme *si: respekti i dinjitetit vetjak, shmangia e paragjyqimeve dhe diskriminimit të të gjitha llojeve;*



- të tregojnë interes për çështjet publike dhe kontribuojnë në zgjidhjen e problemeve në nivel shkolle dhe komuniteti;
- të sistemojnë dhe ruajnë materialet dhe detyrat mësimore në formate elektronike.

Arsimi i Mesëm i Lartë (AML): Klasat X-XII

Në këtë nivel, në fokus janë zhvillimi i përgjithshëm përmes procesit të nxënies më të specializuar. Njëherazi, përvetësimi i kompetencave kyçe ndihmon dhe lehtëson orientimet e nxënësve për studime akademike ose për kualifikime profesionale që kërkohen në tregun e punës. Nxiten nxënësit të përsosin metodat dhe mjetet për të nxënë gjatë gjithë jetës. Kjo nënkupton nxënien për t'iu qasur informacionit në mënyrë efikase, për ta vlerësuar atë në mënyrë kritike e me kompetencë dhe për ta shfrytëzuar në mënyrë krijuese. Në gjimnaze ose në institucionet e arsimit me drejtim të orientuar, procesi i përvetësimit të dijeve dhe zhvillimi i kompetencave bazohet në nevojën e të rinjve për të marrë përgjegjësi për jetën e tyre si qytetarë aktivë kompetentë, për të vijuar arsimimin në nivele më të larta ose për t'u përfshirë me sukses në tregun e punës.

Gjatë nxënies në këtë nivel, përmbajtjet mësimore dhe metodologjitë e të nxënit të sigurojnë që të rinjtë dhe të rejat të ndihmohen kryesisht:

- të kuptojnë, zhvillojnë dhe komunikojnë saktë ide / informacione në gjuhën shqipe standarde;
- të lexojnë, të shkruajnë, të dëgjojnë e të komunikojnë në mënyrë të pavarur në një gjuhë të huaj;
- të komunikojnë ide dhe informacione brenda fushës së tyre të interesit në një gjuhë të huaj të dytë;
- të analizojnë faktorët kryesorë që ndikojnë në zhvillimin e shoqërisë;
- të demonstrojnë aftësi manipulimi në zgjidhjen problemore dhe të komunikojnë në mënyrë efektive idetë matematikore;
- të zhvillojnë përgjegjësitë ndaj mjedisit dhe të angazhohen për zhvillimin e qëndrueshëm;
- të ndërveprojnë me individë dhe grupe individësh të kulturave të ndryshme.
- të interpretojnë informacionin në mënyrë kritike dhe të përgjegjshme, nëpërmjet dialogut, kërkimit të së vërtetës dhe përmes debatit të hapur;
- të kuptojnë vlerat e trashëgimisë kulturore historike, duke e vlerësuar këtë trashëgimi si pjesë të përcaktimit të identitetit të një populli;



- të marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes demokratike në të gjitha nivelet (*p. sh. , në familje, në shkollë, në komunitet, si dhe në proceset e politikave vendore dhe shtetërore*);
- të kuptojnë botën si bashkësi sistemesh të ndërvarura;
- të thellojnë njohjen dhe kuptimin e ligjeve bazë të shkencave të natyrës dhe teknologjisë;
- të kuptojnë vlerën praktike të njohurive të fituara;
- të marrin, analizojnë, vlerësojnë dhe të përdorin informacione nga burime të ndryshme;
- të krijojnë sistemin e tyre të vlerave, për të kuptuar çështjet morale dhe shpirtërore;
- të përdorin TIK-un për të mbledhur dhe interpretuar të dhëna nga burime të ndryshme;
- të njohin dhe angazhohen në mënyrë efektive me softuerët, inteligjencën artificiale dhe robotët;
- të përdorin teknologjinë digjitale për të krijuar dhe bashkëpunuar me të tjerët për plotësimin e qëllimeve personale, sociale ose tregtare;


VII. FUSHAT KURRIKULARE DHE LËNDËT QË PËRFSHIJNË⁽⁵⁾

Fushat kurrikulare përbëjnë bazën e organizimit të përmbajtjeve mësimore dhe procesit të nxënies në institucionet arsimore, për çdo nivel arsimor. Kurrikula e arsimit parauniversitar përmban këto fusha:

1. Gjuhët dhe komunikimi
2. Matematika
3. Shkencat e natyrës
4. Shkencat shoqërore
5. Teknologjia dhe TIK-u
6. Artet
7. Edukimi fizik, sportet dhe shëndeti

Çdo fushë përcakton rezultatet e të nxënit që orientojnë përzgjedhjet e përmbajtjeve dhe situatave mësimore që zhvillohen në procesin mësimor. Njëherazi, arritja e tyre dëshmon zotërimin e kompetencave kyç nga nxënësit. Fushat përfshijnë një ose më shumë lëndë që zhvillohen të orientuara nga rezultatet e të nxënit të përcaktuara në programet lëndore përkatëse.

⁽⁵⁾ Njohuritë, aftësitë dhe vlerat, të cilat nxënësit vijojnë t'i ndërtojnë e përsosin gjatë nxënies së lëndëve që përfshihen në çdo fushë si dhe rezultatet e të nxënit me të cilët nxënësit dëshmojnë zotërimin e tyre, do të përshkruhen në Kurrikulat Bërthamë të niveleve dhe programet e lëndëve.



7.1. Fusha “Gjuhët dhe komunikimi”

Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” u mundëson nxënësve të zhvillojnë dhe të përdorin gjuhët si mjete komunikimi në jetën e përditshme, në veprimtaritë e tyre profesionale dhe shoqërore. Nëpërmjet kësaj fushe, nxënësit ndërtojnë, shprehin dhe interpretojnë koncepte, ide, ndjenja, fakte, opinione, me gojë dhe me shkrim; zhvillojnë kompetencat për të lexuar, shkruar, folur dhe dëgjuar në mënyrë aktive dhe të qëllimshme; dallojnë dhe përdorin tekste të ndryshme letrare dhe jo letrare të shtypura ose virtuale; gjejnë, krahasojnë, analizojnë e vlerësojnë informacione të ndryshme; zotërojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e duhura rreth sistemit gjuhësor; përdorin gjuhën në mënyrë pozitive dhe të përgjegjshme në marrëdhëniet shoqërore; kuptojnë, analizojnë dhe vlerësojnë tekste të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare, nga krijimtaria e autorëve që janë përfaqësues të periudhave të ndryshme nga letërsia shqipe dhe ajo botërore. Në këtë fushë përfshihen:

- Gjuha shqipe
- Letërsia
- Gjuha amtare për pakicat kombëtare
- Gjuha e huaje parë
- Gjuha e huaj e dytë
- Gjuha e shenjave


Gjuha shqipe mësohet në të gjitha klasat e arsimit fillor, e arsimit të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë.

Secila lëndë mësimore në kuadër të kësaj fushe përfshin edhe letërsinë, si pjesë e përdorimit të gjuhës në raport me vlerat estetike. Në arsimin e mesëm të lartë, Letërsia zhvillohet si lëndë e veçantë e kësaj fushe.

Gjuha e huaj e parë mësohet në të gjitha klasat e të tri niveleve të arsimit parauniversitar. Gjuha e huaj e dytë mësohet si lëndë e kurrikulës bërthamë në arsimin e mesëm të ulët dhe e përfshirë në kurrikulën me zgjedhje në arsimin e mesëm të lartë. Nxënësi mund të zgjedhë të zhvillojë si gjuhë të huaj të dytë, njërën nga gjuhët: gjuhën frënge, gjuhën italiane, gjuhën gjermane dhe gjuhë të tjera sipas specifikave të institucionit arsimor etj.

Mësimi i gjuhëve mbështetet në politikat gjuhësore të Këshillit të Evropës për të promovuar diversitetin kulturor dhe gjuhësor dhe në qasjen e Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për gjuhët dhe Volumit Shoqërues.

Njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat që nxënësi zotëron në fushën “Gjuhët dhe



komunikimi”, janë bazë për arritjet e nxënësve edhe në fusha të tjera të nxënies dhe më pas në jetë.

7.2. Fusha “Matematikë”

Matematika përfaqësohet si *fushë e nxënies* dhe si *lëndë mësimore*. Formimi matematik i nxënësve duhet t’i përgjigjet kërkesave të shoqërisë së sotme e cila ka nevojë për njerëz të aftë të përdorin dhe interpretojnë njohuritë dhe procedurat e zgjidhjes së problemeve matematike në kontekste të larmishme. Matematika mundëson zhvillimin e personalitetit të nxënësve, zhvillimin e kapaciteteve të tyre për të menduar në mënyrë kritike dhe për të punuar në mënyrë të pavarur. Ajo nxit kuriozitetin për zbulime dhe dije të reja, me qëllim zbatimin e tyre dhe zgjidhjen e situatave problemore në jetën e përditshme; pajis nxënësin me modelet e të menduarit matematik, me idetë thelbësore dhe strukturat matematikore, me njohuri dhe shprehje matematike të nevojshme për jetën dhe për arsimim të mëtejshëm.

Matematika mësohet në të gjitha klasat e arsimit fillor, e arsimit të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë. Një nga aspektet më të rëndësishëm është integrimi i përmbajtjeve mësimore matematike në fushat kurrikulare.

Nëpërmjet nxënies së matematikës, nxënësit do të jenë në gjendje të kuptojnë rolin e të menduarit matematikor për zhvillimin e shkencës dhe të teknologjisë moderne, si dhe rëndësinë e zbatimit të matematikës në situatat e zgjidhjes së problemeve nga jeta reale. Në këtë fushë/lëndë, nxënësit vlerësojnë matematikën në tërësi si formë e përshkrimit të realitetit, si metodë e njohjes së tij dhe si pjesë e kulturës njerëzore dhe progresit shoqëror.

7.3. Fusha “Shkencat e natyrës”

Fusha “Shkencat e natyrës” ndihmon në formimin shkencor të nxënësve, nëpërmjet zhvillimit të njohurive shkencore, aftësive dhe qëndrimeve, të nevojshme për të hetuar, për të zgjidhur problemet, për të marrë vendimet, për të bërë pyetje e kënaqur kureshtjen e tyre dhe për të nxënë gjatë gjithë jetës. Përvojat e të nxënit nëpërmjet situatave të ndryshme në shkencë u krijojnë nxënësve mundësi të shumta për të eksploruar, analizuar, vlerësuar, sintetizuar, çmuar dhe kuptuar marrëdhëniet ndërmjet shkencës, teknologjisë, shoqërisë dhe mjedisit të cilat ndikojnë në jetën, karrierën dhe të ardhmen e tyre. Nëpërmjet nxënies së shkencave të natyrës, ata vlerësojnë rolin e tyre në çështjet vendore, kombëtare dhe globale që lidhen me shëndetin, burimet natyrore, mjedisin dhe ndikimin e veprimtarisë njerëzore dhe dukurive natyrore mbi të. Të nxënit e shkencave të natyrës bazohet në metodën empirike, në vëzhgime dhe matje, si dhe në metodën racionale, në mendimin logjik matematikor. Duke u krijuar nxënësve mundësitë e kryerjes së veprimtarive



praktike në mënyrë të pavarur, ata provojnë kënaqësinë e zbulimit shkencor dhe plotësojnë kuriozitetin për botën që i rrethon. Në këtë mënyrë, ata sfidojnë vetveten për të bërë pyetje dhe për të nxjerrë përfundime të bazuara në të dhëna dhe fakte përmes metodave shkencore.

Mësimi i shkencave të natyrës në arsimin fillor realizohet përmes lëndës Dituri natyre, ndërsa në arsimin e mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë nëpërmjet lëndëve të veçanta: Biologji, Fizikë dhe Kimi.

7.4. Fusha “Shkencat shoqërore”

Fusha “Shkencat shoqërore” i aftëson nxënësit të jenë qytetarë aktive, të informuar dhe të përgjegjshëm për veten dhe shoqërinë. Nxënësit zhvillojnë kompetencat për të luajtur rolet si anëtarë të një shoqërie demokratike, në një botë gjithnjë e më të ndërvarur. Ata aftësohen të vlerësojnë pasojat e ndërveprimit të shoqërisë me mjedisin për të marrë veprime që ndihmojnë zhvillimin e qëndrueshëm. Fusha krijon premisa për të nxitur nisma dhe sipërmarrje.

Nxënësit përsosin bazat e qytetarisë duke kuptuar ligjshmërinë, konceptin e kohës, të vazhdimësisë dhe të ndryshimit, në këndvështrimin e marrëdhënieve historike dhe e zbatojnë këtë kuptim në analizën e pasojave të veprimeve individuale dhe kolektive në shoqëri, në të kaluarën dhe sot; zgjerojnë këndvështrimin hapësinor për botën, për kompleksitetin dhe ndërvarësinë e vendeve dhe të rajoneve; mësojnë të mendojnë në mënyrë kritike, të marrin përgjegjësi dhe angazhohen në veprime për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e tij të qëndrueshëm.

Kjo fushë i ndihmon nxënësit të zhvillojnë një ndjenjë humanizmi të gjerë, të kuptojnë zhvillimin e personalitetit të tyre, të kuptojnë mënyrën si ata ngjasojnë dhe diferencohen nga të tjerët në raport me kohën dhe me hapësirën, të dallojnë diferencën midis supozimit dhe faktit, të mos besojnë në përgjigjen e paargumentuar dhe të respektojnë vërtetësinë e burimeve duke dalluar analogjinë false, për t’u bërë pjesëtarë të përgjegjshëm të shoqërisë, të cilët dinë të trajtojnë në mënyrë kritike një fenomen të epokës së tyre.

Përvojat mësimore të kësaj fushe i shërbejnë përmbushjes së qëllimeve arsimore, si kultivimi i identitetit personal, shoqëror, kombëtar e kulturor, edukimit për të jetuar së bashku, edukimit për zhvillim të qëndrueshëm etj.

Fusha e shkencave shoqërore, në arsimin fillor përfshin lëndët Qytetari dhe Histori, ndërsa në arsimin e mesëm të ulët përfshin lëndët Qytetari, Histori dhe Gjeografi. Në arsimin e mesëm të lartë, fusha e shkencave shoqërore përfshin lëndët Qytetari, Filozofi, Histori, Gjeografi, Ekonomi, Sociologji dhe Psikologji.



7.5. Fusha “Teknologji dhe TIK”

Teknologjia dhe TIK-u janë duke u përdorur gjithnjë e më shumë në shoqëri dhe ekonomi. Ata po transformojnë mënyrat e punës, studimin, komunikimi, marrjen e informacionit dhe mundësitë për të kaluar në mënyrë produktive edhe kohën e lirë. Kompetencat që zhvillon kjo fushë u shërbejnë nxënësve për të qenë pjesëtarë aktivë në zhvillimet e vrullshme të shoqërisë dhe për t’u përballuar me sfidat e kësaj shoqërie.

Fusha “Teknologji dhe TIK” përfshin lëndët: Teknologji e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) dhe Aftësim teknologjik praktik, në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët; Teknologji e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) dhe Teknologji në arsimin e mesëm të lartë.

Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) luan një rol të rëndësishëm në kurrikul, duke ofruar përfitime që përmirësojnë përvojën e të mësuarit për nxënësit dhe mësuesit. Mjetet digjitale, softuerët arsimorë, burimet online, përmbajtjet multimediale, simulimet dhe lojërat edukative mund t’i bëjnë konceptet komplekse më të lehta për t’u kuptuar. Nëpërmjet TIK-ut, nxënësit mund të ndërtojnë dhe analizojnë konceptet, lidhjet dhe proceset informatike; të formulojnë dhe organizojnë ide në të gjitha fushat e të nxënësve. TIK-u lehtëson bashkëpunimin ndërmjet nxënësve dhe mësuesve, duke thyer barrierat gjeografike. Platformat online, forumet e diskutimit dhe projektet bashkëpunuese u mundësojnë nxënësve të punojnë së bashku dhe të ndajnë idetë. TIK-u lejon përvoja të personalizuar të nxënësve, duke u përshtatur nevojave individuale dhe stileve të nxënësve. Platformat e personalizuar të mësimit dhe aplikacionet edukative mund të ofrojnë përmbajtje dhe vlerësime personale.

Teknologjia iu siguron nxënësve të njohin mundësitë profesionale më të kërkuara dhe të shndërrohen në qytetarë të informuar, në një botë që ndryshon shpejt. Të gjithë nxënësit duhet të bëhen pjesëmarrës aktivë në të nxënësve të tyre individual. Ata duhet të zhvillojnë aftësitë e tyre për zgjidhjen e problemeve, si dhe ndjenjën e përgjegjësisë për të nxënësve vetjak, duke përsosur më tej strategjitë për të nxënësve gjatë gjithë jetës. Teknologjia i ndihmon nxënësit të zhvillojnë aftësi thelbësore të shkrim-leximit digjital. Ata mësojnë të lundrojnë në platformat online, të përdorin mjete produktiviteti dhe të vlerësojnë në mënyrë kritike informacionin digjital.

7.6. Fusha “Artet”

Fusha e arteve është pjesë e rëndësishme e kurrikulës, sepse studimi i arteve lidhet ngushtë me zhvillimin intelektual, emocional, social dhe kulturor të nxënësve. Artet janë pjesë e jetës së përditshme ku gjenden të mishëruara aspekte të kulturës materiale, shpirtërore, artistike,



intelektuale dhe emocionale, ku ndërveprojnë kultura dhe shoqëria.

Kjo fushë luan një rol të rëndësishëm në formimin dhe zhvillimin e nxënësve, duke i ndihmuar të kuptojnë, të shprehin përvojat e tyre vetjake, të kultivojnë talentet, të përvetësojnë konceptet themelore për përdorimin e teknikave apo burimeve të ndryshme artistike; të mësojnë të komunikojnë, të interpretojnë dhe të zhvillojnë shkathtësitë e tyre artistike për t'u shprehur, si dhe të ndihmojnë në zhvillimin artistik e kulturor të vetes dhe të shoqërisë. Fusha e arteve mundëson zhvillimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtar, nëpërmjet trajtimit të elementeve dhe vlerave artistike kulturore të trashëgimisë sonë kombëtare, me të cilat përfaqësohet kombi ynë brenda vendit dhe më gjerë, si pjesë integrale e të nxënësve në art.

Njohuritë e qëndrueshme artistike, të marra në fushën e arteve mund t'i hapin rrugën studimeve të mëtejshme që kanë lidhje me profesione dhe mundësi punësimi në fushën e arteve dhe kulturës.

Fusha e arteve në arsimin fillor përfshin lëndët Art pamor, Muzikë, Kërcim dhe Teatër, ndërsa në arsimin e mesëm të ulët përfshin lëndët Art pamor, Muzikë dhe Teatër. Në arsimin e mesëm të lartë, lëndët: Art pamor, Muzikë dhe Teatër ofrohen si pjesë e kurrikulës me zgjedhje.

7.7. Fusha “Edukim fizik, sporte dhe shëndeti”

Fusha e edukimit fizik, sporteve dhe shëndetit në arsimin parauniversitar synon që nxënësit të zhvillojnë njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e nevojshme të cilat sigurojnë mirëqenien e shëndetit të tyre mendor, emocional, fizik dhe social dhe ndihmojnë përballjen me sfidat e jetës.

Kjo fushë integron edukimin fizik dhe sportet me edukimin shëndetësor, duke përfshirë njohjen e mënyrave të jetës së shëndetshme apo mbrojtjen prej sëmundjeve dhe rreziqeve prej tyre. Edukimi fizik dhe sportet shihen si mjet ideal për promovimin e aktivitetit të rregullt fizik, edukimin e një stili jetese të shëndetshme e aktive dhe fitimin e kompetencave të rëndësishme e të vlefshme përgjatë gjithë jetës. Fusha u mundëson nxënësve zbatimin praktik të njohurive teknike e taktike të fituara në disiplinat sportive; zbatimin e rregulloreve të disiplinave sportive; kryerjen e kombinacioneve lëvizore me përmbajtje të aftësive lëvizore bazë, të manipulimit lëvizor me dhe pa mjete, kryerjen e elementeve të thjeshta akrobatike; zbatimin e rregullave të sigurisë gjatë të ushtruarit me aktivitet fizik e sportiv; njohjen dhe respektimin e dhënies së ndihmës së parë në raste të traumave që ndodhin gjatë aktivitetit fizik; zbatimin në jetën e përditshme të parimeve të Olimpizmit, Filozofisë Olimpike dhe të Fair-Play. Nëpërmjet aktivitetit fizik e sportiv, nxënësit marrin pjesë në shumë veprimtari fizike e sportive, individualisht dhe në grup, kuptojnë rëndësinë e të ushtruarit sistematik, edukojnë disiplinën, vullnetin, vetëvlerësimin, konkurrencën. Gjithashtu,



fusha i ndihmon nxënësit të vlerësojnë sportin si alternativë karriere.

Edukimi fizik, sportet dhe shëndeti zhvillohet përgjatë të gjitha klasave të arsimit fillor, të arsimit të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë.

VIII. SHPËRNDARJA E KOHËS MËSIMORE PËR FUSHAT E TË NXËNIT

Ekulibri i fushave të të nxënit në kurrikulën e arsimit parauniversitar është thelbësor për t'u ofruar nxënësve një arsimim të plotë, i cili i përgatit ata për sfidat dhe mundësitë që do të hasin në arsimin e lartë, karrierë dhe më gjerë. Ky ekuilibër siguron që nxënësit të zhvillojnë një grup gjithëpërfshirës të aftësive, njohurive dhe kompetencave në fusha të ndryshme, duke nxitur zhvillimin e tyre holistik dhe duke u mundësuar atyre të lulëzojnë në një botë gjithnjë e më komplekse dhe të ndërlikur.


Fushate ndryshme të të nxënit: si gjuhët, shkencat e natyrës, matematika, shkencat shoqërore, artet, edukimi fizik, kontribuojnë në *zhvillimin holistik* të nxënësve. Duke caktuar orë të mjaftueshme mësimore në secilën prej këtyre fushave, mësuesit mund të sigurojnë që nxënësit të marrin një edukim të plotë që ushqen rritjen e tyre njohëse, emocionale, sociale dhe fizike.

Çdo fushë e të mësuarit ofron mundësi unike për *zhvillimin konjitiv*. Për shembull, matematika nxit arsyetimin logjik dhe aftësitë për zgjidhjen e problemeve, ndërsa letërsia dhe artet stimulojnë kreativitetin dhe të menduarit kritik. Balancimi i orëve të mësimin në këto fusha i lejon nxënësit të zhvillojnë një gamë të larmishme aftësish njohëse, duke rritur kapacitetin e tyre për kërkim intelektual dhe inovacion.

Duke u ofruar nxënësve ekspozim ndaj një sërë disiplinash gjatë arsimit parauniversitar, mësuesit mund t'i ndihmojnë ata të eksplorojnë interesat dhe prirjet e tyre, të marrin vendime të informuara për *rrugët e tyre akademike dhe të karrierës* dhe të zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë themelore të nevojshme për sukses në fushat e tyre të zgjedhura. .

Një kurrikul e balancuar i ekspozon nxënësit ndaj një gamë të gjerë *këndvështrimesh kulturore, kontekstesh historike dhe çështjeve globale*. Duke studiuar lëndë të tilla si historia, gjeografia dhe gjuhët e huaja, nxënësit zhvillojnë një vlerësim për diversitetin kulturor, një kuptim të ndërvarësisë globale dhe aftësinë për të lundruar në mënyrë efektive në mjediset multikulturore.

Edukimi fizik, edukimi shëndetësor dhe të mësuarit socio-emocional janë thelbësore të një kurrikule të ekuilibruar që promovon *mirëqenien e përgjithshme dhe rritjen personale* të nxënësve. Duke caktuar orë mësimore në këto fusha, mësuesit mund t'i ndihmojnë nxënësit të




zhvillojnë zakone të shëndetshme, aftësi ndërpersonale, elasticitet dhe vetëdije, duke hedhur themelet për shëndetin dhe lumturinë gjatë gjithë jetës.

8.1 Shpërndarja e kohës sipas fushave të të nxënimit në arsimin bazë

Nr.	Përgatitore										
		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	
1	GJUHËT DHE KOMUNIKIMI	25%	43%	43%	44%	38%	38%	36%	33%	31%	31%
2	MATEMATIKA	20%	17%	17%	16%	15%	15%	14%	13%	13%	13%
3	SHKENCAT E NATYRËS	10%	4%	4%	4%	8%	8%	7%	13%	19%	19%
4	SHOQËRIA DHE MJEDISI	10%	4%	4%	4%	8%	8%	11%	17%	16%	16%
5	ARTE	15%	9%	11%	12%	8%	9%	11%	7%	6%	6%
6	EDUKIMI FIZIK, SPORTI DHE SHËNDETI	10%	13%	13%	12%	12%	11%	11%	10%	9%	9%
7	TEKNOLOGJI DHE TIK	5%	4%	4%	4%	8%	8%	7%	3%	3%	3%
8	KURRIKULA NË BAZË SHKOLLE	5%	4%	4%	4%	4%	4%	4%	3%	3%	3%
	TOTALI	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%

8.2 Shpërndarja e kohës sipas fushave të të nxënimit në arsimin e mesëm të lartë

FUSHA & LËNDA	KLASA X	KLASA XI	KLASA XII
	(Orë /javë)	(Orë /javë)	(Orë /javë)
GJUHËT DHE KOMUNIKIMI	22%	22%	21%
MATEMATIKE	13%	13%	18%
SHKENCAT E NATYRËS	19%	19%	0%
SHKENCAT SHOQËRORE	19%	19%	9%
TIK	6%	3%	0%
EDUKIMI FIZIK, SPORTE DHE SHËNDETI	9%	9%	9%
KURRIKULA ME ZGJEDHJE	6%	9%	38%
KURRIKULA ME BAZË SHKOLLE	6%	6%	6%
TOTALI	100%	100%	100%



IX. TEMA NDËRKURRIKULARE

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Të tilla janë identiteti kombëtar, qytetaria aktive dhe sipërmarrja, siguria dhe shëndeti mendor e fizik, identiteti kulturor dhe njohja e kulturave, zhvillimi i qëndrueshëm, teknologjia, media dhe shoqëria, pjesëmarrja në komunitet, edukimi global etj. Temat ndërkurrikulare ndihmojnë nxënësit të interpretojnë botën dhe të rrisin lidhjen e arsimit me jetën dhe interesat e tyre, prandaj kurrikula e arsimit parauniversitar i kushton vëmendjen të veçantë atyre.

- **Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.** Arsimi duhet t’u krijojë nxënësve mundësi për të formuar identitetin kombëtar e kulturor, çka u jep mundësi atyre të kuptojnë trashëgimisë kulturore kombëtare dhe të krijojnë një këndvështrim pozitiv e pranues të përvojave, kulturave dhe mënyrave të jetesës së minoriteteve etnike, kulturore dhe grupeve shoqërore.
- **Qytetaria aktive dhe sipërmarrja.** Kultivimi i tyre i përgatit nxënësit si qytetarë të shoqërisë së sotme dhe të nesërme që respektojnë të drejtat e tyre dhe të të tjerëve, të aftë për të menduar dhe vepruar në mënyrë konstruktive për mirëqenien vetjake, shoqërore dhe ekonomike, në një vend demokratik, brenda komunitetit ndërkombëtar.
- **Shëndeti mendor e fizik dhe siguria.** Në këtë kontekst, çdo veprimtari kurrikulare duhet t’i shërbejë aftësisë së nxënësve për të fituar e demonstruar sjellje pozitive shëndetësore për të parandaluar sëmundjet dhe rreziqet, për të vlerësuar shëndetin, për të ndihmuar të tjerët në situata të jashtëzakonshme etj.
- **Zhvillimi i qëndrueshëm dhe qëndrueshmëria mjedisore.** Përmes tij garantojmë mundësitë e brezave të sotëm dhe të ardhshëm për një jetë më të mirë. Kurrikula e përditësuar mundëson që nxënësit të zbulojnë sfidat e zhvillimit të qëndrueshëm në këndvështrime të ndryshme, të cilat kanë të bëjnë me ndikimet e veprimtarisë së njeriut mbi mjedisin, me ndryshimet klimatike dhe sfidat që i shoqërojnë, me problemet që lidhen me rritjen e popullsisë, varfërinë dhe urinë; burimet e ripërtërishme të energjisë dhe kursimin e saj etj.
- **Teknologjia, shoqëria dhe media.** Zhvillimi i teknologjisë bazohet në nevojën e njerëzve për të përmirësuar cilësinë e jetës. Kurrikula e përditësuar duhet të zhvillojë te nxënësit aftësitë e përdorimit të TIK-ut, aftësitë e përdorimit të gjuhës shqipe dhe gjuhëve të huaja. Vend kryesor në sigurimin e kulturës së komunikimit te nxënësit ka aftësimi i tyre për të përdorur median për përfitim të informacionit dhe të shprehjes së tij. Gjithashtu, edukimi për përdorimin e mediave kërkon zhvillimin e aftësive verbale, pamore, dëgjuese, teknike e sociale të nxënësve.



X. KURRIKULA ME ZGJEDHJE⁽⁶⁾ DHE KURRIKULA NË BAZË SHKOLLE

10.1 Kurrikula me zgjedhje

Kurrikula me zgjedhje është pjesë e kurrikulës e cila zhvillohet në përputhje me interesat e nxënësve, brenda kohës së planifikuar në planin mësimor. Kurrikula me zgjedhje u ofron nxënësve mundësinë të zgjedhin disa nga lëndët/ modulet sipas preferencave të tyre; ajo përfshin një menu lëndësh/modulesh nga e cila nxënësit janë të detyruar të zgjedhin. Lënda/moduli me zgjedhje ka status të njëjtë me lëndët e kurrikulës bërthamë, d.m.th., e detyrueshme nxënësit që e përzgjedhin. Kurrikula me zgjedhje përshtat mësimin me nevojat e nxënësve dhe u ofron atyre më shumë liri dhe përgjegjësi për zgjedhjet e arsimit. Nëpërmjet saj, sigurohet:

- *Personalizimi i nxënies:* Nxënësit kanë mundësinë të zgjedhin lëndët që janë më të pëlqyera për ta, duke e personalizuar kështu përvojën e tyre të mësimin.
- *Zhvillimi i interesave specifike:* Nxënësit kanë mundësi të fokusohen në fusha të caktuara që i interesojnë dhe që mund t'i ndihmojnë në zhvillimin e tyre personal dhe profesional.
- *Motivimi dhe zhvillimi i talenteve në matematikë dhe në shkencat e natyrës (fizikë, biologji, kimi):* Nxënësit zhvillojnë potencialin e tyre intelektual në STEM dhe zotërojnë një kuptim më të thelluar të koncepteve komplekse. Ata përfitojnë nga një mjedis mësimor sfidues, i pasuruar që promovon mendimin kritik dhe krijues, si dhe aftësitë e zgjidhjes problemore. Kurrikula ofron mundësi për thellim, zgjerim, kërkim të pavarur dhe mësim ndërdisiplinor, duke i frymëzuar këta nxënës të shkëlqejnë dhe të krijojnë në fushat e tyre të interesit.
- *Përgatitja për karrierën:* Kurrikula me zgjedhje ofron lëndë apo module të specializuara që lidhen me fushën e mundshme të karrierës për të cilën nxënësi është i interesuar. Lista e lëndëve/moduleve të kurrikulës me zgjedhje përfshin edhe modulet profesionale të cilët i ndihmojnë nxënësit të vendosin një marrëdhënie konkrete dhe të drejtpërdrejtë me veprimtaritë praktike me karakter profesional, si dhe të krijojnë premisa për një orientim më të mirë të nxënësve për sipërmarrjet dhe përgatitjen për tregun e punës.
- *Autonomia dhe përgjegjësia:* Nxënësit mësojnë të marrin vendime dhe të jenë të përgjegjshëm për zgjedhjet, duke u përgatitur për përgjegjësi më të mëdha në të ardhmen.

⁽⁶⁾ Procedurat për organizimin e “Kurrikulës në bazë shkolle” dhe “Kurrikulës me zgjedhje” rregullohen me akte nënligjore dhe dokumente të tjera kurrikulare.



- *Të nxënit modular:* Mësuesi ndan një përmbajtje të caktuar mësimore në njësi të veçanta të njohura si module. Çdo modul fokusohet në një temë, koncept ose aftësi specifike dhe është projektuar për të qenë i pavarur, por i integruar në kuadrin e përgjithshëm kurrikular.

10.2 Kurrikula në bazë shkolle

Kurrikula në bazë shkolle përfshin veprimtari që institucioni arsimor zhvillon për të përmbushur interesat dhe nevojat arsimore të nxënësve. Ajo mund të planifikohet, zhvillohet dhe realizohet përmes një lënde të veçantë/moduli apo projekti, të lidhur me fushate nxënies/lëndët mësimore dhe temat ndërkurrikulare; mund të përfshijë përforcimin e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve në fusha të caktuara të nxëni; mund të përfshijë veprimtari shtesë që ndihmojnë në zhvillimin e kompetencave si: projekte, shërbim komunitar, orientim për karrierë, veprimtari sportive, artistike, klube në lëndë të ndryshme etj.

Kurrikula në bazë shkolle, duke filluar nga arsimit fillor deri në arsimin e mesëm të lartë, planifikohet dhe organizohet për një periudhë të caktuar, zakonisht një vit shkollor. Disa ndër karakteristikat kryesore që duhen mbajtur parasysh në planifikimin dhe zhvillimin e kurrikulës në bazë shkolle përfshijnë:

- *Qëllimet/Rezultatet e të nxënit:* Përcaktohen rezultatet e të nxënit që duhet të arrijnë nxënësit gjatë periudhës së caktuar.
- *Struktura e veprimtarive:* Përshkruhen veprimtaritë që do të zhvillohen gjatë vitit shkollor.
- *Materialet dhe burimet:* Specifikohen burimet dhe materialet mësimore (libra, video, softuerë, etj.) që do të përdoren për të mbështetur veprimtaritë.
- *Metodologjitë mësimore:* Identifikohen metodat/ strategjitë mësimore (praktikat mësimore, projektet, diskutimet etj.) që do të përdoren për të ndihmuar nxënësit në arritjen e qëllimeve.
- *Vlerësimi:* Specifikohen mënyrat e vlerësimit të arritjeve, përfshirë detyrat dhe vlerësimin e përgjithshëm të performancës së nxënësve.
- *Bashkëpunimi me prindërit dhe nxënësit:* Përshkruhen detajet mbi ndërveprimin me prindërit dhe nxënësit në shkollë, përfshirë konferenca, raporte periodike dhe aktivitete shkollore.

Të dy llojet e kurrikulave (kurrikula me zgjedhje dhe kurrikula në bazë shkolle) përmirësohen sistematikisht dhe u përshtaten nevojave të nxënësve, atyre lokale dhe kontekstit shkollor.



XI. METODOLOGJITË E TË NXËNIT EFEKTIV⁽⁷⁾

Mësimdhënia dhe të nxënit efektiv përfshin një kombinim qasjesh, strategjish, metodash dhe teknikash që përdoren për të mbështetur të nxënit efektiv dhe zhvillimin e kompetencave të nxënësve në mjediset mësimoret. Këto strategji dhe metoda marrin parasysh dhe plotësojnë nevojat e të nxënit si dhe sigurojnë pjesëmarrjen aktive të nxënësve në përzgjedhjen dhe shfrytëzimin e informacionit, duke nxitur përgjegjshmërinë vetjake, iniciativën, reflektimin, pavarësinë e gjyqimit, vetëvlerësimin, bashkëpunimin dhe barazinë.

Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar në Shqipëri promovon:


Të nxënit me në qendër nxënësin. Mësuesi duhet të përshtatë metodat dhe teknikat sipas nevojave, interesave dhe veçorive individuale të nxënësve. Përdorimi i burimeve të ndryshme të të nxënit nxit pjesëmarrjen aktive të nxënësve në çdo veprimtari mësimore dhe krijon një klimë bashkëpunimi e cila i motivon ata.

Të nxënit që promovojnë kompetencat. Procesi mësimor i bazuar në kompetenca kërkon strategji, metoda dhe teknika që organizojnë dhe integrojnë përvojat mësimore të nxënësve me njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që duhen ndërtuar e zbatuar prej tyre. Mësimdhënia dhe të nxënit bazuar në kompetenca është e lidhur ngushtë me procesin e vlerësimit. Për të vlerësuar arritjet e nxënësve duhet të përzgjidhen teknika dhe instrumente vlerësimi që u mundësojnë nxënësve demonstrimin e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve dhe jo vetëm riprodhimin e njohurive. Në këtë mënyrë mësuesit do të mund të sigurojnë informacion për cilësinë e mësimin, arritjet e nxënësve dhe zhvillimin e kompetencave.

Të nxënit e diferencuar. Njohja dhe adresimi i nevojave, interesave dhe stileve të ndryshme të të nxënit të nxënësve është thelbësor për një mësimdhënie efektive. Përdorimi i teknikave të diferencuara për të përshtatur përmbajtjen, qasjen dhe vlerësimin e nxënësve sipas nevojave individuale të çdo nxënësi ndihmon nxënësit të nxënë pavarësisht stileve të tyre të nxënit. Trajtimi specifik i nxënësve të talentuar dhe atyre që kanë vështirësi në të nxënë është përparësi e procesit mësimor. Mësuesit mund të përdorin një sërë teknikash, materialesh dhe vlerësimesh për të trajtuar preferencat dhe aftësitë e ndryshme mësimore brenda klasës.

Të nxënit e integruar. Të nxënit e integruar ka të bëjë më integrimin dhe lidhjen e përmbajtjeve

⁽⁷⁾ Metodologjitë efektive në kontekste konkrete mësimore kushtëzohen nga niveli që arrin zhvillimi i nxënësve, nga përmbajtja e temave mësimore, kushtet specifike të mjedisve shkollore etj. Për këto arsye karakteristikat e metodologjive mësimore përshkruhen hollësisht në programet lëndore dhe udhëzuesit përkatës.



mësimore të fushave kurrikulare (p. sh. , fusha “Shkenca shoqërore” me fushën “Shkencat e natyrës”) dhe lëndëve mësimore (p. sh. , fizikës dhe kimisë). Ndërtimi dhe përdorimi i njohurive dhe kompetencave kyçe kërkon orientimin e veprimtarive mësimore nga rezultatet e të nxënësve që dëshmojnë kompetencat, si dhe ndërtimin e përdorimit nga nxënësit të koncepteve, ideve, fakteve dhe përvojave të fushave dhe disiplinave të ndryshme (p. sh. , aktivitete për të gjetur dhe për të përpunuar informacionin mënyrë efektive dhe të përgjegjshme, nëpërmjet TIK-ut etj.)

Përdorimin e teknologjisë digjitale. Integrimi i teknologjisë në procesin mësimor rrit angazhimin, efektivitetin, lehtëson aksesin në burime dhe informacione dhe ofron mundësi për përvoja të të mësuarit ndërveprues. Mjetet e teknologjisë, burimet digjitale dhe prezantimet multimediale lehtësojnë përvojat interaktive të të nxënësve dhe mbështesin nevojat të ndryshme mësimore. Komunikimi, bashkëpunimi dhe aksesin në informacion mund të ndodhin pavarësisht nga koha dhe vendi. Përdorimi i softuerëve arsimor, burimeve multimediale, platformave online dhe i mjeteve digjitale në mësim zhvillon mundësi të reja didaktike dhe metodologjike. Ato mbështesin lloje të ndryshme të nxënësve, promovojnë nxënësit me talente dhe mbështesin nxënësit me aftësi ndryshe.

Mësimin e kombinuar. Mësimdhënia dhe të nxënësve të kombinuar është një qasje arsimore e cila ndërthur dhe kombinon mësimin në klasë, mësimin online, mësimin në grup të vogël, mësimin individual, etj. Kjo metodë synon të ofrojë një përvojë mësimore më të pasur dhe më të personalizuar për nxënësit. Gjatë mësimin të kombinuar nxënësit mund të zhvillojnë mësimin në mjedisin fizik të klasës, por gjithashtu mund të përdorin teknologjinë për të pasur qasje në mësimin të tjera, materiale shtesë, ose për të kryer aktivitete të tjera të mësimin jashtë mjedisit fizik të klasës. Kjo mund të përfshijë përdorimin e platformave online të mësimin, video mësimin, forumeve të diskutimit, dhe burimeve të tjera të teknologjisë që mund të ndihmojnë në mësimin dhe kuptimin e lëndës.

Një aspekt i rëndësishëm i kësaj qasje është mundësia për të ndryshuar dhe përshtatur mësimin sipas nevojave dhe preferencave të nxënësve, duke krijuar një përvojë mësimore më fleksibël dhe të personalizuar për secilin nxënës. Kjo ndihmon në përmirësimin e angazhimit dhe suksesit të nxënësve në mësim dhe në përshpejtimin e zhvillimit dhe progresit të tyre. Për shembull, një nxënës që ka aftësi më të avancuara në një fushë të caktuar mund të përfitojë nga mësimi individual ose nga projekte shtesë që e sfidojnë atë në mënyrë më të thellë. Nga ana tjetër, një nxënës që ka nevojat shtesë për mbështetje mund të përfitojë nga mësimi në grupe të vogla ose nga burime shtesë për t’u ndihmuar në përvetësimin e lëndës.



Të nxënit të bazuar në projekt. Mësimdhënia bazuar në projekte përfshin nxënësit në një punë afatgjatë dhe kërkon që ata të hulumtojnë, të planifikojnë, të bashkëpunojnë dhe të paraqesin gjetjet ose zgjidhjet e tyre. Projektet mund të jenë ndërlëndore dhe mundësojnë kreativitetin, zgjidhjen problemore dhe mësimin e pavarur. Pjesëmarrja e nxënësve në projekte siguron zbatimin e njohurive dhe aftësive në një kontekst praktik.

Të nxënit të bazuar në probleme. Kjo metodë promovon kërkimin, aftësitë për zgjidhjen e problemeve dhe zbatimin e njohurive në kontekste autentike. Nxënësit punojnë për zgjidhjen e problemeve të botës reale ose studimeve të rasteve, shpesh në grupe të vogla.

Angazhimin aktiv. Angazhimi i nxënësve në mënyrë aktive në procesin e të nxënit nxit kuptimin më të thellë, përvetësimin e përmbajtjes dhe zhvillimin e të menduarit kritik. Mësuesit duhet të përfshijnë strategji aktive të të nxënit si diskutime, aktivitete për zgjidhjen e problemeve, eksperimente praktike, debate, simulime dhe projekte bashkëpunuese për të inkurajuar pjesëmarrjen dhe të menduarit kritik.

Zhvillimin e të menduarit kritik dhe zgjidhjes së problemeve. Mësimdhënia efektive inkurajon nxënësit të mendojnë në mënyrë kritike, të analizojnë informacionin dhe të zgjidhin probleme komplekse. Mësuesit duhet të hartojnë aktivitete mësimore dhe vlerësime që sfidojnë nxënësit të zbatojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre në kontekste të botës reale.

Të nxënit në bashkëpunim. Të nxënit në bashkëpunim i inkurajon nxënësit të punojnë së bashku në grupe për të zgjidhur probleme, për të përfunduar projekte ose për të diskutuar ide. Kjo qasje promovon punën në grup, aftësitë e komunikimit, të menduarit kritik dhe të mësuarit nga bashkëmoshatarët.

Të nxënit sipas qasjes STEM. Qasja thekson përvojat e të mësuarit të aplikuar që integron koncepte dhe aftësi nga lëndë të ndryshme (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë). Mësuesit nxisin kuriozitetin, qëndrueshmërinë dhe dashurinë për të mësuarin duke krijuar një mjedis që vlerëson eksplorimin, eksperimentimin dhe inovacionin. STEM thekson zhvillimin e aftësive të të menduarit kritik dhe aftësinë për të zgjidhur probleme komplekse. Nxënësit inkurajohen të analizojnë informacionin, të vlerësojnë provat, të bëjnë parashikime dhe të gjenerojnë zgjidhje kreative për sfidat. Ai ofron mundësi për nxënësit që të mësojnë dhe të eksplorojnë në një kontekst të botës reale, për të kuptuar rëndësinë e koncepteve STEM në jetë, Edukimi STEM inkurajon nxënësit të përqafojnë sfidat, të mësojnë nga dështimet dhe të këmbëngulin përballë pengesave.



Kultivimin e një mjedisi të nxëni miqësor. Një mjedis miqësor, pozitiv dhe mbështetës në klasë nxit besimin, respektin dhe bashkëpunimin midis nxënësve. Mësuesit duhet të krijojnë një hapësirë të sigurt dhe gjithëpërfshirëse ku nxënësit të ndihen rehat të shprehin veten, të ndër marrin iniciativa dhe të ndajnë idetë e tyre. Mësuesit gjithashtu duhet të tregojnë ndjeshmëri, respekt dhe interes të vërtetë për mirëqenien e nxënësve të tyre, duke krijuar një komunitet mësimor mbështetës ku nxënësit ndihen të vlerësuar dhe të motivuar për të pasur sukses.

Të nxënit e bazuar në përvojë. Përqendrimi në përvojën reale të nxënësit dhe përdorimi i situatave autentike për të mbështetur mësimin.


Të nxënit të bazuar në lojëra. Përdorimi i elementeve të lojërave dhe të garës për të motivuar nxënësit dhe për të rritur angazhimin në mësim.

Reflektimin. Inkurajimi i nxënësve që të reflektojnë mbi procesin e tyre të të nxënit e promovon vetëdijen dhe mësimin e vetë rregulluar. Mësuesit mund të përfshijnë aktivitete reflektimi dhe vetëvlerësim për t'i ndihmuar nxënësit të monitorojnë përparimin e tyre dhe të vendosin qëllime për përmirësim.

Feedback-un dhe vlerësimin transparent të arritjeve. Sigurimi i komenteve konstruktive dhe në kohë është thelbësor për të nxënit dhe progresin e nxënësve. Teknikat e vlerësimit formativ, të tilla si kuizet, vetëvlerësimi, vlerësimet ndërmjet nxënësve dhe diskutimet në klasë, lejojnë mësuesit të monitorojnë përparimin e nxënësve dhe të ofrojnë komente që synojnë përmirësimin e tyre. Arritjet e komunikuar qartë dhe komentet rreth tyre janë parakushte të rëndësishme për një kulturë shkollore efikase.

Duke përdorur këto strategji dhe metoda, mësuesit krijojnë mjedise mësimore tërheqëse, dinamike dhe gjithëpërfshirëse, mbështesin zhvillimin e kompetencave, u mundësojnë nxënësve arritjen e plotë të potencialit të tyre duke i përgatitur ata për të pasur sukses në shkollë, në punë, në jetë dhe në shoqërinë e shekullit të 21-të.

Mësimdhënia efektive kërkon reflektim të vazhdueshëm, rritje dhe zhvillim profesional, ndaj mësuesit duhet të kërkojnë vazhdimisht mundësi për të përmirësuar njohuritë, aftësitë dhe praktikatat e tyre të mësimin përmes kërkimit, zhvillimit profesional dhe bashkëpunimit me kolegët.



XII. VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE⁽⁸⁾

12.1 Kuptimi për vlerësimin, qëllimi dhe parimet themelore

Vlerësimi në arsim është procesi gjatë të cilit mblidhen të dhëna dhe gjykohet mbi bazën e një kriteri të caktuar për arritjen e një rezultati arsimor. Qëllimi kryesor i vlerësimit është marrja e vendimeve që synojnë përmirësimin e rezultateve të nxënies dhe procesit mësimor. Kjo kërkon grumbullimin e informacionit për të analizuar dhe vlerësuar të gjithë aspektet e procesit. Praktikrat e vlerësimit ndikojnë fort procesin e të nxënësve.

Kurrikula jonë konsideron këto parime që sigurojnë vlerësime efektive të nxënësve:

- **Vlerësimi është i drejtë.** Metodrat e vlerësimit duhet të mbështeten në objektiva të vendosura paraprakisht dhe qëllimet e pasojat e tij duhet të jenë të qarta për të gjithë të interesuarit.
- **Vlerësimi bazohet në kritere të njëjta, të unifikuara** në nivel kombëtar të njohura, të qarta e të pranueshëm për nxënësit, mësuesit, prindërit dhe të interesuarit e tjerë. Kjo kërkon që këto kritere t'u bëhen të qarta nxënësve dhe prindërve që në fillim të procesit mësimor.
- **Vlerësimi ka në qendër nxënësin.** Qëllimi i vlerësimit është të ndihmojë nxënësin të zhvillojë njohuritë dhe aftësitë e tij. Për këtë arsye, vlerësimi duhet të jetë i përshtatshëm për nivelin dhe nevojat e individit dhe të ofrojë informacione të sakta dhe të rëndësishme për përmirësimin e mëtejshëm të performancës së tij në fushën e caktuar.
- **Vlerësimi është i orientuar nga e ardhmja.** Vlerësimi duhet të sigurojë informacion të vlefshëm dhe të orientuar nga e ardhmja për nxënësin, për prindërit, sikurse edhe për mësuesit dhe shkollat për mënyrën si të përmirësojnë praktikrat e të mësuarit dhe të mësimit.
- **Vlerësimi është i vlefshëm.** Vlerësimi duhet të matë atë që synon.
- **Vlerësimi është i qëndrueshëm.** Ai duhet të prodhojë rezultate të qëndrueshme dhe koherente. Kjo do të thotë që rezultatet e vlerësimit duhet të jenë të përsëritshme në rast se administrohet e njëjta procedurë për të njëjtin nxënës edhe nga një vlerësues i jashtëm.
- **Vlerësimi është i barabartë.** Një metodë e drejtë matjeje/vlerësimi siguron që të gjithë nxënësit, pavarësisht nga karakteristikat e tyre demografike ose karakteristikat e tjera, të kenë

⁽⁸⁾ Zotërimi i kompetencave vlerësohet në bazë të njohurive, aftësive dhe qëndrimeve të përcaktuara në Kurrikulat Bërthamë dhe Programet Lëndore. Rezultatet në fundin e nivelit arsimor u japin ekupeve të mësuesve, nxënësve dhe familjeve të tyre mjetet e nevojshme për të vlerësuar shkallën e përvetësimit të njohurive dhe kompetencave nga secili nxënës gjatë nivelit.



mundësi të barabarta për të treguar nivelin e tyre të kompetencës. Zbatimi i këtij parimi merr rëndësi të veçantë kur rezultatet e vlerësimit të nxënësve janë të rëndësishme për të dhe ndikojnë në të ardhmen e tij.

- **Vlerësimi është transparent.** Transparenca nënkupton që nxënësit duhet të marrin paraprakisht informacione të hapura, të sakta dhe të qarta për vlerësimin. Një procedurë transparente e matjes është ajo në të cilën nxënësit informohen paraprakisht për qëllimin e vlerësimit, për rezultatet e pritshme të nxënies që do të vlerësohen, llojet e procedurave të vlerësimit që do të përdoren dhe kriteret e vlerësimit.
- **Vlerësimi është i zbatueshëm.** Parimi i zbatueshmërisë do të thotë që çdo metodë e matjes duhet të jetë e realizueshme, duke pasur parasysh burimet, kohën dhe kufizimet praktike që zbatohen. Kufizimet që e bëjnë një metodë jopraktike mund ta bëjnë atë edhe jo të qëndrueshme/besueshme dhe të pavlefshme. Ky parim merr më shumë vlerë në rastet kur ekzistojnë kufizime të ndjeshme për nxënës ose grupe të caktuar nxënësish, për shkak të rrethanave objektive.

12.2 Llojet e vlerësimit

Llojet kryesore të vlerësimit arsimor që realizohen në arsimin parauniversitar, janë:

- Vlerësimi i brendshëm (vlerësimi i vazhduar, periodik dhe përfundimtar).
- Vlerësimi i jashtëm (në fund të vitit shkollor, në fund të nivelit).


12.2.1 Vlerësimi i brendshëm⁽⁹⁾

Vlerësimi i brendshëm bëhet në nivel shkolle/klase nga mësuesit, sipas procedurave e kriterëve për secilin lloj të vlerësimit të brendshëm, të rregulluara me akte nënligjore.

Vlerësimi i brendshëm çmon përparimin dhe arritjen e nxënësve, planifikimin e punës me nxënësit, identifikimin e prirjeve dhe të talenteve të nxënësve etj. Ai duhet t'u mundësojë nxënësve të shprehin njohuritë e reja dhe të tregojnë nivelin e kompetencave, duke përfshirë:

- kërkesat e përcaktuara në programet lëndore;
- përballjen me sfida të nivelit të përcaktuar me rezultatet e të nxënit;
- aftësinë për t'i zbatuar ato në situata dhe rrethana të reja.

⁽⁹⁾Vlerësimi i brendshëm organizohet dhe administrohet nga organet e shkollës dhe mbështetet nga autoriteti vendor arsimor, sipas përcaktimit me akte nënligjore të procedurave/ kriterëve për secilin lloj vlerësimit të brendshëm.



LEJDET	KOHA	REALIZUESI	QËLLIMI	DOKUMENTIMI
Vlerësimi i vazhduar	Gjatë procesit të nxënies	Mësuesit e lëndëve.	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ndihma për nxënësit ▪ Informimi dhe raportimi. 	Pasqyrimi i notave në regjistrin elektronik (SMIP)
Vlerësimi periodik	Në fundin e çdo periudhe mësimore	Mësuesit e lëndëve.	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ndihma për nxënësit. ▪ Informimi dhe raportimi. ▪ Vendosja e notës në fund të periudhave të caktuara mësimore. 	Pasqyrimi i notave në regjistrin elektronik (SMIP)
Vlerësimi përfundimtar	Në fund të vitit shkollor	Mësuesit e lëndëve.	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Vendosja e notës përfundimtare në fund të vitit mësimor/ shkollor. ▪ Informimi dhe raportimi. ▪ Planifikimi për mbështetjen e të nxënësit të nxënësve në vitin vijues. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Vlerësimet dhe notat evidentohen në amzën e shkollës dhe në regjistrin elektronik. ▪ Vlerësimet paraqiten në dëftesën e nxënësit.
Vlerësimi në fund të nivelit	Në fundin e klasës përgatitore, klasës V, IX dhe XII.	Drejtorja e shkollës. Ekipi lëndor.	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Verifikimi i arritjeve. ▪ Ndihma e nxënësve për vitin pasues. ▪ Informim dhe raport për prindërit dhe organet eprore. ▪ Diplomimi. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Në vitin përgatitor certifikatë për fëmijën. ▪ Në klasë V dhe IX dëftesa e nxënësit. ▪ Në klasë XII diploma e nxënësit.

12.2.2 Vlerësimi i jashtëm

Me vlerësim të jashtëm do të kuptohet vlerësimi i realizuar nga autoritetet qendrore ose rajonale të arsimit.

Vlerësimi i jashtëm mund të bëhet për qëllime:




- Inspektimi dhe verifikimi i cilësisë së vlerësimit, në nivel klasë apo shkolle.
- Vlerësimi të standardizuar.
- Hulumtimi për përmirësim.
- Vendimmarrjeje arsimore në nivele, fusha ose aspekte të ndryshme.

Arritja e nxënësve vlerësohet nga testet kombëtare bazuara në kampione dhe nga vlerësimet e standardizuara shtetërore që organizohen në përfundim të nivelit arsimor. Këto vlerësime përqendrohen në përcaktimin e nivelit të demonstrimit nga nxënësit të arritjeve të parashikuara për secilin nivel.

Në përfundimin e AML-së, realizohet matja e nivelit të demonstrimit të kompetencave dhe certifikimi për mundësi vazhdimi në studime të larta universitare ose për në tregun e punës.

Vlerësime dhe teste të standardizuara shtetërore	Qëllimet e vlerësimit	Dokumenti i certifikimit
Testet kombëtare bazuar në kampione	Rezultatet përdoren për monitorimin kombëtar të arritjeve.	Nuk ofrohet dokument
Vlerësimi shtetëror në fund të klasës V	Hulumtimi për aspekte të ndryshme të arsimit dhe identifikimi i nevojave për mbështetje të nxënësve në arsimin e mesëm të ulët dhe për përmirësimin e nivelit fillor.	Dëftesa në fund të klasës V
Vlerësimi shtetëror në fund të klasës IX	Matja e nivelit të demonstrimit të arritjeve për regjistrim në arsimin e mesëm të lartë.	Dëftesa në fund të klasës IX
Vlerësimi shtetëror në fund të klasës XII <i>Provimi i Maturës Shtetërore</i>	Matja e nivelit të demonstrimit të kompetencave dhe certifikimi për mundësi vazhdimi në studime të larta universitare.	Diploma e Maturës Shtetërore



XIII. DOKUMENTET KURRIKUARE QË BUROJNË NGA KORNIZA KURRIKULARE

Dokumentet kurrikulare që burojnë nga Korniza Kurrikulare, janë të detyrueshme për t'u zbatuar në arsimin parauniversitar. Ato renditen si më poshtë:

- 📖 Kurrikula e edukimit parashkollor. (3-6 vjeç).
- 📖 Kurrikula bërthamë për klasën përgatitore dhe AF-në,
- 📖 Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të ulët dhe të lartë.
- 📖 Planet mësimore klasa përgatitore deri në klasën XII.
- 📖 Programet lëndore klasa përgatitore deri në klasën XII.
- 📖 Nivelet e arritjeve të nxënësve sipas niveleve arsimore.
- 📖 Tekste shkollore.
- 📖 Materiale plotësuese, udhëzues kurrikulare, materiale didaktike, instrumente për vlerësimin etj.

Në funksion të zbatimit të dokumentacionit kurrikular në nivel shkolle, është e nevojshme të hartohen materiale të ndryshme, si tekste shkollore, materiale plotësuese mësimore, materiale didaktike dhe instrumente për vlerësim.

XIV. KUSHTET PËR ZBATIMIN E KURRIKULËS

Zbatimi i kurrikulës së arsimit parauniversitar kërkon përkushtimin e aktorëve të cilët, drejtpërdrejtë apo tërthorazi, janë të lidhur me punën e shkollës. Gjithsesi, specifikat mund të ndryshojnë në varësi të kontekstit, institucionit përkatës dhe monitorimit të cilësisë.

Për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës dhe dokumenteve të saj, institucioni përkatës përgjegjës, do të përgatisë planin e detajuar me të gjitha veprimtaritë, si dhe buxhetin përkatës për të gjitha aktivitetet që do të organizojë, i cili do të miratohet nga ministria përgjegjëse për arsimin.

Demonstrimi i kurrikulës në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar kërkon që institucioni arsimor të planifikojë dhe të sigurojë kushtet materiale dhe burimet e nevojshme njerëzore, ku me rëndësi konsiderohen:

- ✓ Infrastruktura e shkollës.
- ✓ Personeli mësimor.
- ✓ Shërbimi profesional i shkollës.
- ✓ Drejtuesit e institucionit arsimor.



- ✓ Teknologjia digjitale.
- ✓ Materialet didaktike.

Mbi bazën e gjendjes, institucioni arsimor planifikon masat për të përmirësuar kapacitetet e shkollës në nivelin e domosdoshëm, që të përmbushë kërkesat e kurrikulës dhe zbaton udhëzimet administrative dhe profesionale që konfirmohen nga ministri përgjegjës për arsimin ose agjencitë vartëse të ministrisë.

Në vijim, përshkruhen disa nga kërkesat që duhen plotësuar nga secili prej aktorëve për plotësimin e këtij synimi. Përshkrimi i hollësishëm ofrohet në dokumente të tjera arsimore ose administrative.

Niveli	Institucionet / aktorët	Role dhe përgjegjësi
Kombëtar	MAS	<ul style="list-style-type: none"> - Përcakton politikat dhe udhëzimet gjithëpërfshirëse në lidhje me risitë kryesore në kurrikulën e arsimit parauniversitar. - Bashkëpunon me ekspertë të arsimit për të zhvilluar kurrikulën e APU që përputhet me nevojat dhe kërkesat e tregut të punës. - Siguron infrastrukturën e domosdoshme didaktike dhe teknologjike për zbatimin e kurrikulës. - Koordinon me institucionet e arsimit të lartë përmirësimet e kurrikulës së formimit të mësuesve në koherencë me kurrikulën e APU-së. - Përcakton politikat dhe udhëzimet gjithëpërfshirëse në lidhje me zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë në lidhje me zbatimin e kurrikulës së arsimit parauniversitar. - Koordinon me ofrues të ndryshëm trajnimesh, duke përfshirë universitetet, organizatat dhe institucione të tjera arsimore, për të ofruar programet e trajnimit në lidhje me zbatimin e kurrikulës. - Monitoron zbatimin e kurrikulës së APU-së për të siguruar efektivitetin e tij. - Siguron burime financiare të nevojshme për zbatimin e kurrikulës, në bashkëpunim me aktorë, organizata partnere dhe donatorë. - Bashkëpunon me aktorë të ndryshëm, duke përfshirë sindikatat e mësuesve, për të siguruar koordinimin dhe zbatimin efektiv të kurrikulës së APU-së.
Kombëtar	ASCAP	<ul style="list-style-type: none"> - Koordinon zhvillimin e kurrikulës, planeve mësimore në bashkëpunim me MAS, AKAP, DRAP, ZVAP-të, aktorë dhe institucione të përfshirë në këtë proces.



- Përgatit programet lëndore sipas klasave përkatëse duke përfshirë risitë më të fundit.
- Përgatit materialet mbështetëse dhe udhëzues për mësuesit sipas niveleve arsimore duke përfshirë risitë më të fundit.
- Përgatit programin e zhvillimit profesional të mësuesve për zbatimin e kurrikulës së APU-së
- Zhvillon aftësitë trajnuesve të ToT-ve, drejtuesve të rrjeteve profesionale dhe mësuesve të identifikuar si kapacitete trajnuese për kolegët.
- Mentoron dhe këshillon institucionet arsimore në zbatimin e kurrikulës.
- Koordinon me ofrues të ndryshëm trajnimesh, duke përfshirë universitetet, organizatat dhe institucione të tjera arsimore, për të ofruar programet e trajnimit në lidhje me zbatimin e kurrikulës.
- Monitoron performancën e institucioneve arsimore përmes vlerësimeve dhe inspektimeve të rregullta që lidhen me zbatimin e kurrikulës në procesin mësimor.
- Promovon një kulturë të përmirësimit të vazhdueshëm midis institucioneve arsimore dhe mbështet zbatimin e ndryshimeve të nevojshme për të përmirësuar cilësinë e arsimit.
- Angazhohet me aktorë të ndryshëm, duke përfshirë institucionet arsimore, nxënësit, prindërit dhe organizatat e partnerët.
- Përgatit kornizat e programeve të vlerësimeve kombëtare duke ia vënë në dispozicion institucioneve përkatëse.
- Përgatit modelet e vlerësimeve kombëtare për secilën klasë dhe nivel arsimor
- Zhvillon programin e zhvillimit profesional të punonjësve arsimore lidhur me vlerësimet kombëtare të nxënësve.
- Organizon teste kombëtare sipas standardeve të përcaktuara në kurrikulën kombëtare.
- Zhvillon analiza dhe përgatit raporte në lidhje me të dhënat e arritjeve të nxënësve në provimet kombëtare dhe vlerësimet ndërkombëtare.
- Koordinon zbatimin e kurrikulës, planeve mësimore në bashkëpunim me MAS, ASCAP, DRAP, ZVAP-të, aktorë dhe institucione të përfshirë në këtë proces.

Kombëtar

QSHA

Kombëtar

AKAP



- Siguron infrastrukturën e domosdoshme didaktike dhe teknologjike për zbatimin e kurrikulës.
 - Zbaton programet lëndore sipas klasave përkatëse duke përfshirë risitë më të fundit.
 - Zbaton materialet mbështetëse dhe udhëzues për mësuesit sipas niveleve arsimore duke përfshirë risitë më të fundit.
 - Zbaton programin e zhvillimit profesional të mësuesve për zbatimin e kurrikulës së APU-së.
 - Mentoron aftësitë trajnuesve të ToT-ve, drejtuesve të rrjeteve profesionale dhe mësuesve të identifikuar si kapacitete trajnuese për kolegët.
 - Mentoron dhe këshillon institucionet arsimore në zbatimin e kurrikulës.
 - Monitoron performancën e institucioneve arsimore përmes vlerësimeve dhe inspektimeve të rregullta që lidhen me zbatimin e kurrikulës në procesin mësimor.
 - Promovon një kulturë të përmirësimit të vazhdueshëm midis institucioneve arsimore dhe mbështet zbatimin e ndryshimeve të nevojshme për të përmirësuar cilësinë e arsimit.
 - Monitoron punën e DRAP-ve, ZVAP-ve dhe të institucioneve arsimore në lidhje me zbatimin e kurrikulës.
 - Përgatit raporte monitorimi dhe i dërgon në MAS dhe në ASCAP.
 - Analizon të dhënat e mbledhura nga vlerësimet për të gjykuar cilësinë dhe efektivitetin e zbatimit të kurrikulës.
- | | | |
|-----------------|----------------|--|
| Kombëtar | IAL | <ul style="list-style-type: none"> - Angazhohen dhe marrin pjesë në përmirësimin e kurrikulës së formimit fillestar të mësuesve në koherencë të plotë me risitë e reja të kurrikulës së APU-së. - Bashkëpunojnë me MAS dhe institucionet e varësisë së saj për të zbatuar programin kombëtar të zhvillimit profesional për zbatimin e kurrikulës. - Përgatisin materiale/module trajnimi dhe materiale mbështetëse që shërbejnë për zhvillimin e trajnimeve në përputhje me zbatimin e kurrikulës së APU-së. - Zhvillojnë trajnime me mësuesit në zbatimin e kurrikulës. |
| | Rajonal | DRAP |



- Siguron infrastrukturën e domosdoshme didaktike dhe teknologjike për zbatimin e kurrikulës.
- Zbaton programet lëndore sipas klasave përkatëse duke përfshirë risitë më të fundit.
- Zbaton materialet mbështetëse dhe udhëzues për mësuesit sipas niveleve arsimore duke përfshirë risitë më të fundit.
- Zbaton programin e zhvillimit profesional të mësuesve për zbatimin e kurrikulës së APU-së.
- Mentoron aftësitë trajnuesve të ToT-ve, drejtuesve të rrjeteve profesionale dhe mësuesve të identifikuar si kapacitete trajnuese për kolegët.
- Mentoron dhe këshillon institucionet arsimore në zbatimin e kurrikulës.
- Monitoron performancën e institucioneve arsimore përmes vlerësimeve dhe inspektimeve të rregullta që lidhen me zbatimin e kurrikulës në procesin mësimor.
- Promovon një kulturë të përmirësimit të vazhdueshëm midis institucioneve arsimore dhe mbështet zbatimin e ndryshimeve të nevojshme për të përmirësuar cilësinë e arsimit.
- Monitoron punën e ZVAP-ve dhe të institucioneve arsimore në lidhje me zbatimin e kurrikulës.
- Përgatit raporte monitorimi dhe i dërgon në AKAP.
- Analizon të dhënat e mbledhura nga vlerësimet për të gjykuar cilësinë dhe efektivitetin e zbatimit të kurrikulës.
- Koordinon zbatimin e kurrikulës, planeve mësimore në bashkëpunim me AKAP-in dhe DRAP-et, aktorë dhe institucione të përfshirë në këtë proces.
- Siguron infrastrukturën e domosdoshme didaktike dhe teknologjike për zbatimin e kurrikulës.
- Zbaton programet lëndore sipas klasave përkatëse duke përfshirë risitë më të fundit.
- Zbaton materialet mbështetëse dhe udhëzues për mësuesit sipas niveleve arsimore duke përfshirë risitë më të fundit.

Lokal

ZVAP



- Zbaton programin e zhvillimit profesional të mësuesve për zbatimin e kurrikulës së APU-së.
- Mentoron aftësitë trajnuese të ToT-ve, drejtuesve të rrjeteve profesionale dhe mësuesve të identifikuar si kapacitete trajnuese për kolegët.
- Mentoron dhe këshillon institucionet arsimore në zbatimin e kurrikulës.
- Monitoron performancën e institucioneve arsimore përmes vlerësimeve dhe inspektimeve të rregullta që lidhen me zbatimin e kurrikulës në procesin mësimor.
- Promovon një kulturë të përmirësimit të vazhdueshëm midis institucioneve arsimore dhe mbështet zbatimin e ndryshimeve të nevojshme për të përmirësuar cilësinë e arsimit.
- Monitoron punën e institucioneve arsimore në lidhje me zbatimin e kurrikulës.
- Përgatit raporte monitorimi dhe i dërgon në DRAP-e.
- Analizon të dhënat e mbledhura nga vlerësimet për të gjykuar cilësinë dhe efektivitetin e zbatimit të kurrikulës.
- Koordinon zbatimin e kurrikulës, planeve mësimore në bashkëpunim me ZVAP-në përkatëse.
- Administron planifikimin dhe demonstrimin e kurrikulës në përputhje me kushtet e personelit mësimor dhe siguron infrastrukturën e domosdoshme didaktike dhe teknologjike për zbatimin e kurrikulës.
- Zbaton programet lëndore sipas klasave përkatëse duke përfshirë risitë më të fundit.
- Zbaton materialet mbështetëse dhe udhëzues për mësuesit sipas niveleve arsimore duke përfshirë risitë më të fundit.
- Zbaton programin e zhvillimit profesional të mësuesve për zbatimin e kurrikulës së APU-së.
- Merr pjesë në veprimtaritë trajnuese të organizuara në nivel qendror dhe rajonal.
- Mundëson pjesëmarrjen e punonjësve të vet arsimorë në veprimtari trajnuese për zbatimin e kurrikulës.
- Organizon takime trajnuese dhe informuese me mësuesit e shkollës për të përcjellë çështjet që lidhen me zbatimin e kurrikulës.

Lokal

Drejtuesi i
institucionit
arsimor

- Shpërndan materialet e kurrikulës tek të gjithë anëtarët e stafit të institucionit arsimor.
 - Përkushtohet për përfshirjen e nxënësve, prindërve dhe të komunitetit në vendimmarrje në nivel të klasës dhe të shkollës.
 - Monitoron performancën e mësuesve përmes vlerësimeve të rregullta që lidhen me zbatimin e kurrikulës në procesin mësimor.
 - Monitoron ecurinë e nxënësve, si dhe rezultatet e tyre në fushat e veprimtarive trajnuese të ofruara në kuadër të programit.
 - Përgatit raporte të zbatimit të kurrikulës dhe i dërgon në ZVAP.
 - Koordinon zbatimin e kurrikulës, planeve mësimore në bashkëpunim me stafin drejtues të shkollës.
 - Mbështet mësuesit për planifikimin e kurrikulës në përputhje me infrastrukturën e domosdoshme didaktike dhe teknologjike për zbatimin e kurrikulës.
 - Mbështet mësuesit dhe zbaton programet lëndore sipas klasave përkatëse duke përfshirë risitë më të fundit.
 - Zbaton materialet mbështetëse dhe udhëzues për mësuesit sipas niveleve arsimore duke përfshirë risitë më të fundit.
 - Zbaton programin e zhvillimit profesional të mësuesve për zbatimin e kurrikulës së APU-së.
 - Merr pjesë në veprimtaritë trajnuese të organizuara në nivel qendror, rajonal dhe në nivel shkolle.
 - Organizon takime trajnuese dhe informuese me mësuesit e ekipit kurrikular për të përcjellë çështjet që lidhen me zbatimin e kurrikulës.
 - Shpërndan materialet e kurrikulës tek të gjithë anëtarët e ekipit kurrikular të institucionit arsimor.
-
- Planifikon dhe zgjedh përmbajtje mësimore të përshtatshme për nxënësit, bazuar në lidhjen mes lëndëve dhe fushave kurrikulare.
 - Përdor metoda sipas nevojave, interesave dhe mundësive të nxënësve.
 - Merr pjesë aktive në veprimtari trajnuese për zhvillimin e vet profesional.
 - Angazhohet profesionalisht si anëtar i rrjetit profesional dhe i ekipit kurrikular.

Shkolle

Drejtuesi i
ekipit
kurrikular

Shkolle

Mësuesi



Shkollë	Shërbimi psiko-social	<ul style="list-style-type: none"> - Kujdeset të integrojë çështjet dhe përvojat mësimore që kontribuojnë në zhvillimin e njohurive dhe kompetencave kyçe. - Përgatit materiale të ndryshme mësimore. - Identifikon problemet, vështirësitë, por edhe mundësitë e nxënësve dhe siguron ndihmën e individualizuar të nxënësve - Organizon mësim plotësues bazuar në vlerësimin e arritjeve. - Bashkëpunon me prindërit për të siguruar angazhimin e nevojshëm për nxitjen e përparimit të nxënësve. - Bashkëpunon me kolegët dhe shërbimet profesionale për këmbimin e përvojave, për vlerësimin e përparimit të nxënësve gjatë vitit shkollor, në fund të klasës dhe të niveleve arsimore. - Mbikëqyr vazhdimisht performancën e personelit mësimor. - Ndhmon mësuesit për planifikimin e përvojave të nxënies. - Këshillon drejtuesit e shkollës për çështjet të caktuara mësimore. - Bashkë me mësuesit, identifikon nevojat dhe vështirësitë e nxënësve në nxënie dhe/ose në fushën emocionale dhe i ndihmon ata. - Identifikon mundësitë e shërbimeve publike për realizimin e kurrikulës. - Ndhmon vlerësimin e arritjeve dhe në bashkëpunim me personelin mësimor planifikon programet mbështetëse në nivel shkollë.
Shkollë	Qeveria e nxënësve	<ul style="list-style-type: none"> - Mbron dhe promovon të drejtat e nxënësve për të marrë arsim cilësor. - Ndhmon për çështjet që lidhen me sigurinë dhe mirëqenien e nxënësve. - Trajton shqetësimet, kërkesat dhe rekomandimet e nxënësve për cilësinë e proceseve mësimore me bordin dhe drejtorinë e shkollës.
Shkollë	Këshilli i prindërve të klasës	<ul style="list-style-type: none"> - Ndhmon në përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor. - I propozon mësuesit kujdestar përmirësime në përparimin e nxënësve. - Ndhmon vullnetarisht për të punuar me nxënës me vështirësi në të nxënë ose për të zbatuar module me zgjedhje ose projekte kurrikulare.
Shkollë	Bordi i IA-së	<ul style="list-style-type: none"> - Miraton planin afatmesëm dhe atë vjetor të institucionit; - Miraton planin e shpenzimeve të institucionit për fondet që mund të përdoren në funksion të zbatimit të kurrikulës.



Shkollë

Nxënësi

- Konfirmon kurrikulën e hartuar nga institucioni arsimor në nivel shkollë.
- Njihet sistematikisht me rezultatet e të nxënit.
- Ndjek përparimin e arritur, duke e krahasuar me nivelin e pritshmërisë dhe bën vetëvlerësim të vazhdueshëm.
- Merr pjesë në vendime të rëndësishme për organizimin e punës mësimore në shkollë.
- Merr pjesë në aktivitete të ndryshme kurrikulare për zhvillimin e prirjeve dhe interesave të tij.
- Merr pjesë në aktivitete të ndryshme kurrikulare për përmirësimin e të nxënit.



XV. FJALORI TERMINOLOGJIK

TERMI SHQIP	TERMI ANGLISHT	KUPTIMI I TERMAVE
Aftësi	<i>Skill</i>	Zotësia për të kryer detyra dhe për të zgjidhur probleme që përfshijnë zbatimin praktik të njohurive teorike në detyra ose situata të veçanta.
Aftësitë për jetën	<i>Life Skills</i>	Një grup kompetencash psiko-sociale dhe aftësish ndërpersonale që i ndihmojnë njerëzit të marrin vendime të informuara, të zgjidhin problemet, të mendojnë në mënyrë kritike dhe krijuese, të komunikojnë në mënyrë efektive, të ndërtojnë marrëdhënie të shëndetshme, të kuptojnë të tjerët dhe të përballojnë dhe menaxhojnë jetën e tyre në një mënyrë të shëndetshme dhe produktive.
Edukimi digjital	<i>Digital Literacy</i>	Edukimi që synon edukimin e zotësisë për të përdorur me besim, në mënyrë kritike dhe të përgjegjshme teknologjinë digjitale për qëllime mësimore, për punë dhe për pjesëmarrje aktive në shoqëri. Edukimi digjital përfshin edukimin për median, informimin dhe menaxhimin e të dhënave, komunikimin dhe bashkëpunimin për ndarjen e informacionit, aftësinë për të krijuar përmbajtje digjitale, sigurinë (mirëqenien digjitale dhe kompetencat që lidhen me sigurinë kibernetike), çështjet që lidhen me pronësinë intelektuale, aftësitë e zgjidhjes së problemit dhe të marrjes së vendimit.
Arsim	<i>Education</i>	Procesi i përvetësimit të njohurive, aftësive, vlerave, qëndrimeve gjatë jetës dhe që zhvillohet në mjedise të ndryshme formale dhe / ose joformale dhe që nxit të menduarit kritik, aftësitë për zgjidhjen e problemeve, rritjen personale etj.
Arsim bazë	<i>Basic education</i>	Themeli për të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe për zhvillimi njerëzor mbi të cilin vendet mund të ndërtojnë, sistematikisht, nivelet dhe llojet e mëtejshme të arsimit dhe trajnimit. Arsimi bazë zakonisht përfshin arsimin fillor dhe të mesëm të ulët dhe gjithnjë e më shumë një ose më shumë vite të arsimit parashkollor. Zakonisht, përfshin shkollimin e detyrueshëm
Arsim dhe formim profesional	<i>Vocational education and training</i>	Arsimi që u mundëson nxënësve të fitojnë dhe përdorin njohuri dhe kompetenca për punë dhe kualifikime profesionale për profesione të caktuara, përveç arritjes së kompetencave kryesore të përcaktuara në KK.
Arsim formal	<i>Formal education</i>	Arsim i institucionalizuar, i qëllimshëm, i planifikuar, i strukturuar në mënyrë hierarkike, nga niveli parashkollor deri në atë pasuniversitar. Rezultatet dhe kualifikimet në arsimin formal njihen me certifikata dhe diploma.
Arsim gjithëpërfshirës	<i>Comprehensive education</i>	Procesi i forcimit të kapacitetit të sistemit arsimor për të arritur tek të gjithë nxënësit, në zbatim të parimit se arsimi është një e drejtë themelore e njeriut dhe themeli për një shoqëri më të drejtë dhe më të barabartë.
Arsimi parashkollor	<i>Preschool education</i>	Arsimi parashkollor i përket "Nivelet me kodin 0" (KSNA 0). I cili synon zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik, të çdo fëmije, ushtrimin e rregullave themelore të sjelljes e të higjienës, kultivimin e vlerave, si dhe përgatitjen për arsimin fillor. Përfshin moshën nga 3 deri në 6 vjeç.
Arsim fillor	<i>Primary education</i>	Në SAPU, Arsimi fillor i përket "Nivelet me kodin 1" që merret në klasën përgatitore dhe vijon gjatë pesë viteve të para të shkollimit (KSNA 1). Arsimi fillor ofron aktivitete mësimore dhe edukative të dizajnuara zakonisht për t'u ofruar nxënësve aftësi themelore në lexim, shkrim dhe matematikë (p. sh. shkrim-lexim dhe numërim) dhe vendos një bazë solide për të mësuarit dhe të kuptuarit e fushave thelbësore të njohurive dhe zhvillimit personal, duke u përgatitur për arsimin e mesëm të ulët.
Arsim i mesëm i ulët	<i>Lower secondary education</i>	Në SAPU, niveli i ulët i arsimit të mesëm (katërveçar) (KSNA 2). Programet e arsimit të mesëm të ulët zakonisht janë të dizajnuara për t'u ndërtuar mbi rezultatet e të nxënësve nga arsimi fillor. Zakonisht, qëllimi është konsolidimi i bazës për të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe zhvillimin njerëzor mbi të cilin sistemet arsimore më pas mund të



		zgjerojnë mundësitë e mëtejshme arsimore.
Arsim i mesëm i lartë	<i>Higher secondary education</i>	Në SAPU, niveli i dytë i arsimit të mesëm (trevjeçar) (KSNA 3). Programet e arsimit të mesëm të lartë janë zakonisht arsim i krijuar për të përfunduar arsimin e mesëm në përgatitje për arsimin terciar ose për të ofruar aftësi të rëndësishme për punësim, ose të dyja. Programet e këtij niveli u ofrojnë nxënësve përmbajtje më të larmishme, të specializuara dhe më të thelluara sesa programet në nivelin e arsimit të mesëm të ulët. Ato janë më të diferencuara, me një gamë të shtuar opsionesh të zotërueshme.
Autonomi e shkollës	<i>School autonomy</i>	E drejtë e garantuar shkollës që të vendosë për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës në bazë shkolle, për vlerësimin, menaxhimin e burimeve njerëzore, materiale dhe financiare në dispozicion në kontekstin e kurrikulës zyrtare. Autonomia lidhen me llogaridhënien.
Burim për të nxënë	<i>Learning Resource</i>	Çdo burim – duke përfshirë materialet e shtypura dhe jo të shtypura dhe burimet online/të hapura – që mbështet dhe përmirëson, drejtpërdrejt ose tërthorazi, mësimdhënien dhe të mësuarit. Burimet janë të jashtme (mësuesi, shokët, përmbajtjet e programeve apo tekstet, mjete didaktike etj. , me të cilët nxënësi bashkëvepron, kur trajton situatat) dhe të brendshme (njohuri, aftësi, shkathtësi, vlera, qëndrime etj.).
Burim konjitiv	<i>Cognitive resource</i>	Tërësi e njohurive që ka ndërtuar nxënësi (trashëgimia njohëse e tij); ndryshe, njohuri vetjake dhe / ose shoqërore që ai i aktivizon dhe përdor për trajtimin e situatave.
Burim fizik	<i>Physical resource</i>	Aftësi dhe kapacitete për të përdorur fizikun njerëzor (qëndrueshmëria kardiovaskulare/respiratore, qëndrueshmëria, forca, fleksibiliteti, fuqia, shpejtësia, koordinimi, shkathtësia, ekuilibri dhe saktësia) dhe mjetet fizike për të kryer operacione dhe funksione.
Dije	<i>Knowledge</i>	Njohuri e arsyetuar dhe e provuar si e vërtetë nga komuniteti i kërkuesve sipas kritereve të përcaktuara, e kodifikuar në tekstet akademike, shkollore apo në vepra të specializuara, si produkt i një ose disa shkencëtarëve. Dija është shoqërore.
E-Learning	<i>E-Learning</i>	Të gjitha format e mësimin dhe të nxënimit të bazuar në kompjuter dhe web që përfshijnë përvetësimin dhe zbatimin e njohurive dhe aftësive. Mund të zhvillohet brenda ose jashtë klasës. Ai është shpesh një komponent thelbësor i arsimit në distancë dhe mund të përfshijë mjedise të mësimin virtual.
E-Portofoli	<i>E-Portfolio</i>	Portofol elektronik që shfaq punën, arritjet dhe refleksimet e një nxënësi që përdoret shpesh për vlerësimin dhe paraqitjen e kompetencave të fituara.
Edukimi për sipërmarrje	<i>Entrepreneurship education</i>	Edukimi për sipërmarrje është edukimi që synon zhvillimin e zotësisë për të shfrytëzuar idetë dhe shanset për t'i shndërruar ato në vlera për të tjerët. Ky edukim synon zhvillimin e zotësisë për të përdorur mendimin kritik, aftësitë krijuese dhe të zgjidhjes së problemit, zotësisë për të ndërmarrë nisma e për të qenë këmbëngulës si dhe aftësisë për të punuar në bashkëpunim me të tjerë për të planifikuar dhe menaxhuar projekte me vlera kulturore, shoqërore ose financiare.
Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm	<i>Education for sustainable development</i>	Procesi i zhvillimit të njohurive, aftësive, vlerave dhe qëndrimeve të nxënësve të të gjitha grup moshave, të nevojshme për të trajtuar sfidat e ndërlidhura globale, duke përfshirë ndryshimet klimatike, humbjen e biodiversitetit, përdorimin jo të qëndrueshëm të burimeve dhe pabarazinë. Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm i fuqizon nxënësit të marrin vendime të mirinformuara dhe të ndërmarrin veprime (individuale dhe kolektive) për ndryshimin e shoqërisë dhe kujdesin për planetin.
Inteligjencë artificiale	<i>Artificial intelligence</i>	I referohet teorisë dhe zhvillimit të sistemeve kompjuterike të aftë për të kryer detyra që normalisht kërkojnë inteligjencë njerëzore, të tilla si perceptimi vizual, njohja e të folurit, vendimmarrja dhe përkthimi ndemjet gjuhëve.



Fushë e nxënies / të nxënit	<i>Learning area</i>	Grup lëndësh të ndërlidhura që u ofrojnë nxënësve përmbajtje dhe situata mësimore të cilat i trajtojnë për të ndërtuar / përdorur njohuri të reja dhe kompetenca.
Kodim kompjuterik	<i>Computer coding</i>	Proces i dizenjimit, shkrimit, testimit dhe mirëmbajtjes së kodit burimor ose udhëzimeve për kompjuterin për të interpretuar gjuhët njerëzore.
Kompetencë	<i>Competency</i>	Në kontekstin arsimor, kompetenca kuptohet si kapaciteti / zotësi e personit për të aktivizuar njohuri, aftësi e qëndrime që i ndërton në procesin mësimor ose jashtë tij, me të cilin ai trajton / zgjidh saktë situata jetësore. Kompetenca është thelbësore për të jetuar dhe punuar me sukses në shoqërinë dhe ekonominë e dijes.
Kompetenca kyçe	<i>Key competences</i>	Kompetenca që nxënësi i ndërton gjatë APU-së sepse konsiderohet thelbësore për jetë të suksesshme në shoqërinë dhe në ekonominë e dijes.
Koncept	<i>Concept</i>	Strukturë mendore që personi e ndërton për të përfaqësuar në vetëdije tipare / veti / karakteristika të qenësishme dhe të përbashkëta të një kategorie objektsh / dukurish / procesesh. Koncepti shprehet / paraqitet me simbole (fjalë, shenjë, grafikë etj.).
Kurrikul	<i>Curriculum</i>	Tërësia e parimeve, vlerave, qëllimeve të pranuar shoqërore mbi bazën e të cilave përcaktohen njohuritë, aftësitë, vlerat dhe qëndrimet me të cilat duhet të pajisen nxënësit përmes arsimimit, mënyra e organizimit të përmbajtjes mësimore, pedagogjia e mësimit, përvojat e të mësuarit në të cilat përfshihet nxënësi për t'i realizuar dhe mënyra e vlerësimit të arritjeve.
Kurrikul bazuar në kompetenca	<i>Competency based curriculum</i>	Kurrikula që synon kapacitetin / zotësinë e zbatimit të njohurive dhe aftësive në jetën reale, kurrikula që ka pikënisje dhe pikëmbërritje kompetencën.
Kornizë kurrikulare	<i>Curriculum framework</i>	Dokument që përmbledh argumentimin e nevojave për ndryshime kurrikulare, parimet e përgjithshme mbi të cilat mbështetet kurrikula dhe reformimi i saj, synimet e përgjithshme të kurrikulës, fushat kurrikulare dhe objektivat e tyre të përgjithshëm, drejtimet ndërkurrikulare, parimet e mësimit dhe të nxënit efektiv, si dhe ato të vlerësimit
Korniza STEM	<i>The STEM framework</i>	STEM (ndryshe Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë) është akronim për një qasje arsimore ndërdisiplinore dhe të integruar që fokusohet në këto disiplina. STEM thekson përdorimin e njohurive shkencore, matematikore, teknike dhe inxhinierike për zgjidhjen e problemeve shoqërore, duke e bërë mësimin e shkencës, teknologjisë, inxhinierisë dhe matematikës më kuptimplotë dhe kontekstual.
Kurrikul bërthamë	<i>Core curriculum</i>	Tërësia e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve që pritet të mësohen nga të gjithë nxënësit, përgjithësisht të organizuar në lëndë dhe fusha të nxëni që janë të përbashkëta për të gjithë nxënësit, si gjuhët, matematika, artet, edukimi fizik, shkenca e natyrës dhe shkencat sociale.
Kurrikul që zhvillon shkolla	<i>School based curriculum</i>	Grup i caktuar kursesh / veprimtarish që zhvillon shkolla për të përmbushur nevojat arsimore të komunitetit të shkollës. Kurrikula në bazë shkolle mund të planifikohet dhe realizohet si lëndë e veçantë, modul ose projekt mësimor që përmbajnë tema apo kapituj të lidhur me një fushë të nxëni / lëndë mësimore apo me tema ndërlëndore.
Kurrikul e përvetësuar	<i>Acquired curriculum</i>	Njohuritë, aftësitë, qëndrimet dhe kompetencat që nxënësit zotërojnë në fund të përfundimit të një programi kurrikular ose niveli arsimor.
Kurrikul me zgjedhje	<i>Elective curriculum</i>	Kurset ose lëndët nga të cilat nxënësit mund të zgjedhin sipas interesave dhe nevojave të tyre, të referuara edhe si "kurrikule më zgjedhje". Kjo kurrikul zakonisht ofrohet në arsimin e mesëm dhe të lartë dhe plotëson kurrikulën bazë që duhet të ndjekin të gjithë nxënësit. Zgjedhja e lëndëve në kuadrin e kurrikulës me zgjedhje mund të jetë




		e detyrueshme ose e lirë, në varësi të planit mësimor.
Lëndë mësimore	<i>Subject content</i>	Një degë e dijes e organizuar si një disiplinë mësimore diskrete dhe e mësuar në mënyrë sistematike me kalimin e kohës. Terma të tjerë të përdorur shpesh në mënyrë të ndërsjellë përfshijnë lëndën mësimore, lëndën akademike, disiplinën akademike dhe fushën e studimit/e të nxënit
Llogaridhënie në arsim	<i>Accountability in education</i>	Përgjegjshmëria, transparenca dhe llogaridhënia e institucioneve arsimore, e politik bërësve dhe e aktorëve të tjerë të interesuar në arsim ndaj cilësisë dhe rezultateve të pritshme e të shpallura të arsimit në lidhje me nevojat e nxënësve dhe të shoqërisë.
Mendim kritik	<i>Critical thinking</i>	Zbatimi i aftësive njohëse të analizës, interpretimit, përfundimit, shpjegimit, vlerësimit, monitorimit dhe korigjimit të arsytimit të dikujt. Mendimi kritik përfshin pyetje efektive, mbledhjen dhe renditjen e informacionit përkatës, lidhjen e informacionit të ri me njohuritë ekzistuese, rishqyrtimin e besimeve dhe supozimeve, arsytimin logjik dhe nxjerrjen e përfundimeve të besueshme dhe të besueshme. Zhvillimi i tij kërkon përpjekje të vazhdueshme për të zbatuar konstruktet teorike për të kuptuar një problem, për të marrë në konsideratë provat dhe për të vlerësuar metodat ose teknikat për të formuar një gjykim. Atribute të tilla si kurioziteti dhe fleksibiliteti dhe një qëndrim dyshues janë të lidhura ngushtë me të menduarit kritik. I referuar gjithnjë e më shumë si një kompetencë/kompetencë kyçe dhe aftësi e shekullit të 21-të.
Mendim krijues, krijimtaria	<i>Creative thinking, creativity</i>	Aftësia për të gjeneruar zgjidhje të veçanta dhe origjinale të problemeve në fusha dhe veprimtari të ndryshme jetësore.
Metoda e vlerësimit	<i>Evaluation method</i>	Një proces sistematik i bazuar në standarde që synon të gjykojë efektivitetin e çdo programi të mësimi dhe të nxënit dhe të orientojë veprimet për përmirësim.
Mësim i diferencuar	<i>Differentiated teaching</i>	Një qasje pedagogjike që ka si pikënisje nevojat e ndryshme mësimore të nxënësve dhe kërkon nga mësuesit të përshtatin, në mënyrë fleksibël, mjedisin dhe kushtet e të nxënit, për të siguruar shanse të barabarta për të mësuar për çdo nxënë.
Mësimi i përzier	<i>Blended Learning</i>	Një kombinim i mësimi tradicionale (ballë për ballë) me mësimin dixhital për t'i lejuar nxënësit të kenë kontroll më të madh ose të personalizuar në rrugën e tyre të të mësuarit dhe ritmin individual të të mësuarit, duke pasur dhe përfitimin nga mbikëqyrja e mësuesit.
Mjedis të nxëni	<i>Learning environment</i>	Mjedisi fizik i nxënësit (klasa, shkolla), burimet e vëna në dispozicion për të mbështetur procesin e të mësuarit dhe ndërveprimi social ose llojet e marrëdhënieve shoqërore që funksionojnë brenda këtij konteksti që kanë ndikim në të nxënit.
Mjedis miqësor për fëmijët	<i>Child friendly environment</i>	Një mjedis arsimor dhe komuniteti mbështetës që është gjithëpërfshirës, i shëndetshëm, miqësor, mbrojtës dhe i bazuar në të drejtat. Modeli i shkollës miqësore për fëmijët, i zhvilluar nga UNICEF, promovon gjithëpërfshirjen, ndjeshmërinë gjinore, tolerancën, dinjitetin dhe fuqizimin personal.
Shanse për të mësuar	<i>Learning opportunities</i>	Veprimtari mësimore dhe edukative që zhvillohen në klasë dhe/ose jashtë saj që zhvillohen në një mjedis të sigurt, miqësor e motivues që ofron mundësi të barabarta që të gjithë nxënësit të zhvillojnë potencialin e tyre plotësisht.
Njohuri	<i>Knowledge</i>	Njohuritë, konceptet, idetë dhe teoritë për botën natyrore dhe njerëzore, njerëzit dhe shoqëritë e saj dhe strukturat dhe modelet e tyre të ndërlidhura që janë krijuar nëpërmjet të mësuarit dhe/ose përvojës. Njohuria është personale.
Nxënie / Të nxënit	<i>Learning</i>	Proces psiko-social kompleks dhe afatgjatë me të cilin një individ fiton ose modifikon njohuritë, aftësitë, qëndrimet, vlerat dhe sjelljet përmes përvojës, praktikës, studimit ose udhëzimit. Vini re se përkufizimi i të mësuarit varet nga qasja filozofike dhe psikologjike e përshtatur.



“Nxënës në qendër”	“ <i>Student – centered learning</i> ”	Qasja me në qendër fëmijën, bazohet në të mësuarit konstruktivist që thekson rolin e nxënësit në ndërtimin e kuptimit përmes harmonizimit të informacionit të ri dhe njohurive paraprake, duke zhvilluar autonominë, pavarësinë dhe përgjegjësinë e nxënësit në procesin e të mësuarit e të menduarit.
Orientimi për karrierën	<i>Career guidance</i>	Shërbime dhe aktivitete që synojnë të ndihmojnë individët në çdo moment gjatë jetës së tyre, të marrin vendime të mirinformuara për të bërë zgjedhje arsimore, trajnimi dhe profesionale dhe të menaxhojnë karrierën e tyre. Ai përfshin ofrimin e ndihmës, të informacioneve dhe burimeve për t'i ndihmuar personat të kuptojnë interesat, pikat e forta, dobësitë dhe vlerat e tyre, dhe më pas t'i bashkojnë ato me opsione të ndryshme karriere në sektorin privat.
Përmbajtje mësimore	<i>Subject content</i>	Parimet, teoritë, njohuritë dhe metodologjitë që lidhen me një fushë të caktuar dijeje, të cilat përzgjidhen të kthehen e të organizohen në përmbajtje dhe me qëllime mësimore, në një nivel të caktuar gjerësie e thellësie, në një lëndë shkollore.
Platformë ndërvepruese (interaktive)	<i>Interactive platform</i>	Platformat ndërvepruese janë përmbajtje të synuara dhe të personalizuara dixhitale që mundësojnë një përvojë gjithëpërfshirëse si për komunikimin e jashtëm ashtu edhe për atë të brendshëm. Nëpërmjet një portali ndërveprues në internet, përdoruesit mund të kenë akses, p. sh. në informacione, produkte dhe oferta specifike. Një platformë ndërvepruese ose mund të jetë pjesë e faqes së internetit ose të veproje si një portal i pavarur.
Program mësimor	<i>Program of study</i>	Programi mësimor Një dokument që përshkruan qëllimet, përzgjedhjen dhe rendin e përmbajtjeve që do të mbulojnë, mënyrën e organizimit, materialet që do të përdoren, detyrat dhe aktivitetet mësimore, objektivat ose rezultatet e pritura të të nxënësve dhe skemat e vlerësimit/vlerësimit të një kursi të caktuar, njësie studimi ose lëndë mësimore. Shpesh përdoret si ekuivalent i termit "kurrikula" e marrë kjo në kuptimin e ngushtë të saj.
Përvojë e nxënës	<i>Learning experience</i>	Një shumëllojshmëri e gjerë përvojash në kontekste dhe mjedise të ndryshme që transformojnë perceptimet e nxënësve, lehtësojnë të kuptuarit konceptual, i rrisin inteligjencën emocionale dhe ushqejnë përvetësimin e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve. Në mjediset arsimore, përvojat e të mësuarit janë në mënyrë ideale sfiduese, interesante, të pasura, tërheqëse, kuptimplota dhe të përshtatshme për nevojat e nxënësve. Përvojat e mëparshme të të nxënësve konsiderohen si faktorë kyç që parashikojnë të mësuarit e mëtejshëm.
Proces mësimor	<i>Teaching process</i>	Procesi i planifikuar dhe organizuar nga mësuesi për plotësimin e objektivit që duhet arritur nga nxënësit nëpërmjet 'rajtimit të përmbajtjeve mësimore dhe vlerësimit të arritjeve.
Plani mësimor	<i>Course schedule</i>	Dokument që me vendim të MAS-it, përcakton lëndët për një klasë apo nivel arsimor, fondin e orëve mësimore për secilën lëndë mësimore për secilën klasë.
Qëndrim	<i>Attitude</i>	Një prirje për të menduar dhe për të reaguar ndaj ideve, personave ose situatave në mënyra të caktuara, që e kanë bazën në sistemin e brendshëm të vlerave, bindjeve ose besimeve, të zhvilluara me kalimin e kohës. Qëndrimet ndikohen nga emocionet, sjelljet dhe mendimet dhe prirjen të jenë të varura nga konteksti, të ndjeshme ndaj ndikimit shoqëror dhe të hapura ndaj ndryshimeve. Qëndrimi, si besim, opinion ose marrëdhënie me gjërat ose personat, ndërtohet mes përvojave dhe edukimit.



Rezultat i nxënies	<i>Learning Outcome</i>	Pohime të që referojnë në sjellje të vëzhgueshme e të matshme që përcaktojnë njohuritë, aftësitë ose përvojën specifike që një nxënës duhet të zotërojë gjatë procesit të të mësuarit, në kuadrin e një periudhe shkollimi, trajnimit etj.
Situatë e nxënies	<i>Learning situation</i>	Situata e të mësuarit nënkupton mjedisin e veçantë në të cilin zhvillohet procesi i të nxënies, që përfshin harmonizimin e kushteve, të pajisjeve, të ndërveprimeve dhe të veprimtarisë që modelojnë këtë proces me synim përmbushjen e rezultateve të pritshme të tij.
SMIP	<i>SMIP</i>	SMIP është shkurtime për “Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar” me qëllim përmirësimin e sistemit arsimor në Shqipëri. Ai mbledh dhe përpunon informacionin e APU, duke rritur nivelin e ndërveprimin digjital të shkollave, duke ndihmuar në regjistrimin dhe transferimin e nxënësve nga një shkollë në tjetrën. SMIP mundëson edhe regjistrimin elektronik të notave dhe mungesave.
Standard i përmbajtjes	<i>Content standard</i>	Standardet e përmbajtjes janë një kompromis shoqëror që përcaktojnë çfarë nxënësi duhet të dijë dhe të jetë i aftë të bëjë nga pikëpamja e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve në një fushë të caktuar studimi/lënde, në fund të një cikli shkollimi, në nivel kombëtar
Standard i arritjes	<i>Achievement standard</i>	Standardet e arritjes përcaktojnë nivelet në të cilat nxënësit përmbushin standardet e përmbajtjes ose rezultatet e pritshme në fund të një periudhe arsimore. Standardet e arritjeve miratohen nga autoritet arsimore dhe unifikojnë kriteret e vlerësimit të nxënësit në nivel kombëtar, si një instrument i rëndësishëm që garanton ndershmërinë e vlerësimit. Standardet e arritjeve përdoren nga mësuesit dhe sistemi për vlerësimin e nxënësve
Strategji mësimore	<i>Teaching strategy</i>	Qasje ose metodë e planifikuar dhe sistematike që përfshin përzgjedhjen dhe zbatimin e metodave, teknikave dhe përvojave mësimore për të lehtësuar procesin të mësuarit dhe për të përmbushur objektivat e të mësuarit.
Tekst arsimor dixhital	<i>Digital educational text</i>	Tekste të krijuar përmes teknologjisë digjitale ose elektronike për qëllime arsimore të cilat mund të përdoren në pajisje të ndryshme si kompjuterë, tableta, lexues elektronikë ose telefona inteligjentë, mbulon një gamë të gjerë lëndësh dhe mund të ekzekutohet si tekst shkollor, material mësimor, udhëzues studimi, leksion dhe burime tjera mësimore.
Tema Çështje/tema ndërkurrikulare	<i>Cross curricular issues/ themes</i>	Përmbajtje e rëndësishme kurrikulare që duhet të trajtohen, për shkak të rëndësisë së tyre, edhe përmes lëndë vetë ndryshme, krahas trajtimit në lëndën që e ka objekt të vet të studimit. Të tilla çështje janë për shembull: të drejtat e njeriut, çështjet gjinore, edukimi për paqen, edukimi për zhvillim të qëndrueshëm, mjedisi etj.
Teori konstruktiviste	<i>Constructivism</i>	Konstruktivizmi e sheh të nxënies si një proces në të cilin nxënësi ndërton në mënyrë aktive ide ose koncepte të reja bazuar idetë e reja dhe në njohuritë dhe/ose përvojën e tij të mëparshme.
Teori bihevoriste	<i>Behaviorism</i>	Një teori e të mësuarit e bazuar në idenë se të gjitha sjelljet fitohen përmes kushtëzimit që lind nga ndërveprimi me mjedisin. Bihevoristët besojnë se përgjigjet tona ndaj stimujve mjedisorë formojnë veprimet tona (e njohur edhe si psikologjia e sjelljes).
Të menduar kompjuterik	<i>Computational thinking</i>	Një grup i ndërlidhur aftësish dhe praktikash kompjuterike për zgjidhjen e problemeve komplekse; një mënyrë për të mësuar tema në shumë disiplina dhe domosdoshmëri për të marrë pjesë në një botë digjitale.



Të nxënit gjatë gjithë jetës	<i>Lifelong Learning</i>	Tërësia e aktiviteteve mësimore të ndërmarra gjatë gjithë jetës, që rezultojn në përmirësimin e njohurive, aftësive, kompetencave dhe/ose kualifikimeve për arsye personale, sociale dhe/ose profesionale.
Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK)	<i>Information and Communication Technology (ICT)</i>	Një grup i larmishëm mjedesh dhe burimesh teknologjike të përdorura për të transmetuar, ruajtur, krijuar, ndarë ose shkëmbyer informacion. Këto mjete dhe burime teknologjike përfshijnë kompjuterët, internetin (faqet e internetit, blogjet dhe emailt), teknologjitë e transmetimit të drejtpërdrejtë (radio, televizion dhe transmetim në internet), teknologjitë e transmetimit të regjistruar (podcasting, aktivizues audiosh dhe video dhe pajisje ruajtëse) dhe telefoninë (fikse ose celulare), satelit, vizion/video-konferencë etj.).
Nxënie elektronike	<i>E-learning</i>	Të gjitha format e mësimin dhe të nxënit të mbështetur në mënyrë elektronike, veçanërisht përvetësimi dhe zbatimi i njohurive dhe aftësive të bazuara në web dhe kompjuterik mund të zhvillohet brenda ose jashtë klasës. Ai është shpesh një komponent thelbësor i arsimit në distancë dhe mund të përfshijë mjedise të të mësuarit virtual.
Vlerësim	<i>Evaluation</i>	Një proces sistematik që synon të gjykojë efektivitetin e çdo programi të mësimin dhe të nxënit dhe të orientojë veprimet për përmirësim.
Vetëvlerësimi	<i>Self-evaluation</i>	Vlerësimi me anë të të cilit nxënësi mblodh informacion dhe reflekton mbi të mësuarit e tij ose të saj, gjykon shkallën në të cilën ai pasqyron qëllimet ose kriteret e shprehura në mënyrë eksplicite, identifikon pikat e forta dhe të dobëta dhe rishikon në përputhje me rrethanat. Është vlerësimi i vetë nxënësit për përparimin personal në njohuri, aftësi, procese dhe qëndrime.
Vlerësim diagnostikues	<i>Diagnostic evaluation</i>	Vlerësimi synon identifikimin e pikave të forta dhe të dobëta të nxënësit me synimin për të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të përmirësuar të nxënit. Ai tenton të përdoret si një formë para vlerësimi që ndihmon një mësues për të diagnostikuar vështirësitë e një nxënësi dhe për të vlerësuar gatishmërinë ose nivelin e arritjeve të nxënësit, në mënyrë që të drejtojnë plan programin dhe planifikimin e mësimin dhe nivelin e diferencimit dhe/ose individual ose mbështetje në grup që mund të jetë e nevojshme.
Vlerësimi (matja) i arritjeve	<i>Educational assessment</i>	Vlerësimi (matja) në arsim nënkupton përshkrimin sistematik dhe matjen e nivelit të zotësisë ose të arritjeve të një nxënësi. Kjo i ndihmon mësuesit të kuptojnë nëse dhe në çfarë shkalle procesi i mësimin i ka ndihmuar e mbështetur nxënësit në mënyrë efektive në zhvillimin e kompetencave të synuara, duke ofruar informacion të vlefshëm për planifikimin dhe përshtatjen e fazave vijuese të mësimin
Vlerësim formues i arritjeve	<i>Formative assessment</i>	Vlerësimi i kryer gjatë gjithë procesit arsimor me synimin për të përmirësuar të nxënit e nxënësve. Ai nënkupton: nxjerrjen e provave për të mësuarit për të mbyllur hendekun midis performancës aktuale dhe asaj të dëshiruar (në mënyrë që të ndërmerren veprime për të mbyllur hendekun); ofrimin e komenteve për nxënësit; dhe përfshirja e nxënësve në procesin e vlerësimin dhe të të nxënit.
Vlerësimi përmbledhës	<i>Summative assessment</i>	Vlerësimi i arritjeve të nxënësit në fund të një semestri, stadi, kursi ose programi zakonisht, megjithëse jo domosdoshmërisht, përfshin testim ose provime formale. Vlerësimi përmbledhës përdoret më së shpeshti për renditjen, vlerësimin dhe/ose promovimin e studentëve dhe për qëllime certifikimi.
Vlerësim autentik	<i>Authentic assessment</i>	Vlerësimi autentik buron nga të mësuarit autentik, që përfshin detyra dhe veprimtari që pasqyrojnë sfidat e botës reale dhe standardet e performancës. Ky vlerësim kërkon nga nxënësit zotërimin e aftësive të larta mendore dhe ato të zgjidhjes së problemeve komplekse përmes detyrave që kërkojnë zbatime praktike të njohurive të zotëruara. Si i tillë, të mësuarit dhe vlerësimi autentik ndihmon nxënësit të shohin lidhjen e të mësuarit me jetën reale.
Vlerësim	<i>External</i>	Një proces dhe metodë vlerësimi që e zhvillon dhe e përdor një agjenci apo organ vlerësues që të bëjë një gjykim



i jashtëm	<i>evaluation</i>	për cilësinë e arritur.
Vlerësim i shokut nga shoku	<i>Peer-to-peer evaluation</i>	Vlerësimi i arritjes së një nxënësi nga shoku i tij.



KONTRIBUES NË PËRDITËSIMIN E KORNIZËS KURRIKULARE

Dokumenti u përgatit nën kujdesin e Znj. Ogerta Manastirliu, Ministër i Arsimit dhe Sportit.

Udhëhoqi procesin e përditësimit të kornizës Kurrikulare

- Kabineti i Ministrit të Arsimit dhe Sportit.
- Drejtorja e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar
- Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP).
- Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP).
- Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA)

Grupi i punës:

- Znj. Nina Guga, kryetar (MAS)
- Znj. Zamira Gjini, anëtar (MAS)
- Z. Pëllumb Karameta, anëtar (MAS)
- Znj. Jonida Çollaku, anëtar (MAS)
- Z. Shkëlqim Allkaj, anëtar (MAS)
- Z. Gerti Janaqi, anëtar (ASCAP)
- Znj. Dorina Rapti, anëtar (ASCAP)
- Z. Astrit Dautaj, anëtar (ASCAP)
- Znj. Aurora Balliu (QSHA)
- Znj. Rezarta Basha, anëtar (AKAP)

Falënderim për kontributin dhe mbështetjen gjatë këtij procesi

- Z. Erzen Tola, (MAS)
- Znj. Voltisa Koci, (MAS)
- Z. Besnik Rama, (MAS)
- Znj. Kristina Bregu, (MAS)
- Znj. Nadire Pilavi, (MAS)
- Znj. Elisabeta Paja, (ASCAP)
- Znj. Miranda Kurti, (ASCAP)
- Znj. Ines Todhe, (ASCAP)

